



# VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.7(444)

KORRIK 2025

ÇMIMI: 30 LEKË



Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI & BASHKIM HISARI ; website: www.VETERANIOBVL.ORG

### 82 VJETORI

#### 10 KORRIKU, NGJARJE KULMORE NË HISTORINË E LANÇ



Gjeneral Rahman Parllaku

FAQE 2

### DOSSIER

#### LUFTA E KOPLIKUT DHE HEROIZMI I MALSORËVE

U krijuan tre batalione me luftëtarë. Komandantë batalionesh ishin Sylç Beg Bushati, Hamit Gjybegu dhe Taip Shkodra

Nga Sakip Cami



FAQE 4

### KUMTESA

#### KARAKTERI ATDHETAR I LUFTËRAVE TË SKËNDERBEUT



Prof. ALI HOXHA

FAQE 6

Përmbillet me sukses stërvitja shumëkombëshe me një ceremoni të veçantë

## “DEFENDER EUROPE 25” -

### FORCAT SHQIPTARE, ROL KYÇ NË ZBATIMIN E SKENARËVE STËRVITORË

#### Kur kremtohej 100 vjetori i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit

Beqir Shehu

Me 8 qershor 1878, Abdyl Frashri, Iljaz Pash Dibra, Sheh Mustafa Tetova, Ali Bej Guçia, Ahmet Bej Koronica lanë Stambollin e u nisën me tren për Kosovë. Në Selanik u bashkuan me delegatët e Janinës dhe në mbrëmjen e 9 qershorit arritën në Prizren.

VIJON NË FAQEN 11



### PROFILI

#### MAJOR ELTON MYRKU, U MBYT NË DET PËR TË SHPËTUAR DY JETË



GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË E KA KONSIDERUAR AKT HEROIK HUMAN DHE VETMOHUES

Halil Rama – Mjeshtër i Madh FAQE 6

### SUPLEMENTI LETRAT

#### Zabit Lleshi, libër për dëshmorët e Bashkisë Bulqizë

Prof.asoc.dr. BERNARD ZOTAJ

FAQE 14

#### HYSNI SHAQIRI, PA DROJË PËR BASHKIMIN KOMBËTAR

SHPENDI TOPOLLAJ FAQE 14

#### Dashuria për vendlindjen në poezinë e Destan Ramës

Bujar Karoshi FAQE 15

#### Pikturat e Vesel Xhaferit, “opus” me mesazh të qartë njerëzor

Fatmir Minguli FAQE 12


• Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji: “Defender Europe - 25’ konfirmoi edhe një herë angazhimin e palëkundur të Shteteve të Bashkuara si aleat strategjik në forcimin e sigurisë rajonale dhe euroatlantike”

FAQE 3

### LIBRI I 29-TË I HALIL RAMËS

Më 17 korrik 2025, ora 18.00, promovimi në Akademinë e Shkencave nga OBVL dhe “Univers”

## PËRJETËSIMI I TË VIRTUTSHMIT MEHDI LUCA



Ish-Sekretar i Organizatës së Rinisë Antifashiste NÇI për Reç e Dardhë

Prof.dr. Petrit BARA Mjeshtër i Madh&Zv/Rektor i Universitetit “LUARASI

FAQE 13

### AKTUALITET

#### DEGA E ODA PUKË ZHVILLOI KONFERENCËN E TRETË

FAQE 16

### ESSE

#### VETERANË TË LUFTËS E TË PUNËS NGA LUKANI RRËZË RUNJËS

MEVLUD BUCI

FAQE 11

82 VJETORI

Në emër të dënimit të diktaturës nuk duhet të mohojmë Luftën Nacional Çlirimtare

# NGJARJE KULMORE NË HISTORINË E LANÇ



Gjeneral Rahman Parllaku\*

Në një artikull të botuar gjashtë vjet më parë në një të përditshme shqiptare si dhe në gazetën tonë "Veterani", gjeneral Rahman Parllaku – Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, do ta konsideronte krijimin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare si ngjarje kulmore në historinë e LANÇ. Veç të tjerash Parllaku jepte vlerësime objektive për historinë e LANÇ, si u morën e u zbatuan vendimet për organizimin e luftës partizane që e çuan popullin tonë në fitoren e lirisë, të metat, gabimet e shtrembërimet që ju bënë programit të luftës duke dëmtuar çështjen kombëtare.

**SHTABI I PËRGJITHSHËM I UNCSH DHE ROLI I TIJ**

Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm, më 10 Korrik 1943, me vendim të Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar e zgjidhi problemin e drejtimit të përqëndruar të Ushtrisë. Kjo do të përkujtohet si dita e themelimit të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Në përbërjen e Shtabit të Përgjithshëm u emëruan figurat më të afirmuara udhëheqëse të Luftës. Në këtë shkrim nuk kam marrë përsipër të flas gjatë për fillnisjen dhe vazhdimësinë e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, pasi kjo u takon historianëve, por të përkujtoj e të them diçka për një nga datat më të rëndësishme në historinë e Ushtrisë Shqiptare, atë të krijimit të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare. Gjykoj se kjo datë do të zërë vendin e merituar në analet e historisë së kombit tonë. Viti 1943 shënoi rritje në përmasa të mëdha të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në gjithë vendin ishin krijuar njësitë guerile, çeta e batalione partizane. Luftimet zhvilloheshin, jo të veçuara nga çetat e batalionet, por të përbashkëta e të koordinuara brenda qarkut. Po në korrik të atij viti filluan të zhvilloheshin veprime luftarake të përbashkëta edhe në mes qarqeve

të ndryshme, siç ishin luftimet e Përmetit, ku morën pjesë forcat e Gjirokastrës, Korçës e Beratit. Shtimi i radhëve të Ushtrisë partizane, çlirimi i krahinave të ndryshme, jehona e luftës të përhapur në të gjithë vendin u ndien edhe në botën e jashtme dhe u vlerësuan nga Fuqitë e Mëdha të Aleancës Antifashiste. Ata e njohën Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, dërguan përfaqësuesit e tyre pranë Shtabit të Përgjithshëm, Zonës së Parë Operative, qarqeve e njësisve që ta ndiqnin nga afër e ta ndihmonin atë. Ky nivel i ri i Luftës Antifashiste kërkonte që Ushtria të kishte një strukturë të re organizative, të njëjtë si për repartet sulmuese dhe territoriale, ashtu edhe për krijimin e njësisve taktiko-operative për veprime në të gjithë vendin. Rritja sasiore dhe cilësore e ushtrisë kërkonte drejtim unik dhe bashkërendim të veprimeve luftarake në shkallë vendi.

**HAP CILËSOR NË DREJTIM TË LUFTIMEVE**

Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, më 10 Korrik 1943, me vendim të Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar e zgjidhi problemin e drejtimit të përqëndruar të Ushtrisë.

Kjo do të përkujtohet si dita e themelimit të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në përbërjen e Shtabit të Përgjithshëm u emëruan figurat më të afirmuara udhëheqëse të Luftës. Komandant i Shtabit u caktua Spiro Moisiu, që ishte jo vetëm luftëtar i afirmuar, por edhe i paisur me kulturë ushtarake. Me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm u bë një hap cilësor në drejtim të luftimeve, u bë kalimi nga një ushtri partizane me bazë rajonale në një ushtri mbarëkombëtare me strukturë organizative që t'i përgjigjej jo vetëm stadi të arritur, por edhe perspektivës të kalimit në ushtri të rregullt. Shtabi i Përgjithshëm mori masa të menjëherëshme për organizimin e strukturave ushtarake si të forcave operative, territoriale dhe të administratës ushtarake. Në forcat operative hynin brigadat sulmuese, që ishin të destinuara të vepronin në gjithë hapësirën e territorit të vendit dhe forcat territoriale që vareshin nga komandant e qarqeve.

**LANÇ ZË NJË VEND TË VEÇANTË NË HISTORINË TONË KOMBËTARE**

"Është në nderin e popullit tonë që me Luftën Nacional Çlirimtare u bashkua me koalicionin më demokratik të kohës, luftoi krahas aleatëve anglo-sovjeto-amerikanë e popujve të robëruar që shkatërru-



an fashizmin barbar. Duke pohuar ato që ka mohuar diktatura, duke u dhënë vendin që meritojnë për kontributin në luftë gjithë patriotëve, duke dënuar shtrembërimet e veprimet ekstremiste të kryera nga udhëheqja e partisë komuniste e komandave të veçantë në luftë dhe menjëherë pas çlirimit, askush nuk ka të drejtë të mohojë luftën e gjakun e derdhur për çlirimin e vendit, qofshin këta patriotë, të rinj komunistë, ata që ranë për një ideal, çlirimin e vendit dhe vendosjen e pushtetit demokratik, tjetër se u shkel amaneti i tyre nga diktatura, u deziluzionuan e u persekutuuan pjesa më e vendosur e atyre që mbetën gjallë. Askujt nuk i jepet e drejta të mohojë gjakun e sakrificat e tyre në luftën e shenjtë për liri. Unë kam bindjen se me fitoren e demokracisë historia do të shkruhet nga historianë të ndershëm, në bazë të dokumenteve pa shtrembërimet e deformime të ndikuara nga forca politike të caktuara, nuk do të shkruhet nga institute, që e shkruanin atë siç ua diktonte zyra e diktatorit, as siç duan ta shtrembërojnë e deformojnë forca të caktuara ekstremiste e arriviste. Ndjej kënaqësi kur kujtohen njerëz të vrarë e të persekutuuar për pikëpamjet e tyre politike, për qëndrimin opozitar ndaj diktaturës dhe që nuk kanë bërë asnjë krim ndaj kombit, përkundrazi ka pasur shumë prej tyre që kanë kryer vepra patriotike, kanë kontribuar në luftën për çlirim, si dhe në demokratizimin e jetës së vendit dhe indinjohesh kur forca të caktuara duke përfutur nga vendosja e demokracisë kërkohet të re-

habilitojnë, të quajnë heronj deri kuislingë e kriminelë të njohur që së bashku me fashistët italianë e nazistët gjermanë kanë vrarë mijëra vetë e kanë bërë shkrumb e hi krahina të tëra dhe bashkë me ta edhe komandantë bandash të njohur për terror ndaj popullit.

Organizatat e veteranëve të Luftës Nacional Çlirimtare, nëse janë vërtetë të tilla, duhet të mbrojnë e të njohin mbi baza të drejta këtë luftë. Ata duhet të dënojnë diktaturën e Enver Hoxhës dhe krimet e kryera prej saj dhe të dënojnë shtrembërimet që i janë bërë historisë së Luftës Nacional Çlirimtare. Kombit tonë o sot o kurrë i duhet bashkim e jo përçarje, aq më tepër kjo duhet të kuptohet e kërkohet nga veteranët e LANÇ e pasardhësit e tyre, po t'i kenë të shenjta interesat kombëtare e jo të mbjellin përçarje. Ky bashkim mund të arrihet, kur ne veteranët t'i shikojmë gjerat të çliruara nga ndrydhja e 50 vjetëve të diktaturës, ku çdo kërkese ose mendim për të ndryshuar diçka nga ajo që e kishte vendosur udhëheqja e diktaturës quhej herezi e vepërimitari e armikut të klasës dhe këtë luftë klase e shtrinte edhe brenda familjes. Tani duhet t'i analizojmë gjerat me sy kritik, të hedhim poshtë e të dënojmë me forcë çdo gjë që ka dëmtuar interesat e kombit, të mbështesim me të gjitha forcat zhvillimet demokratike në Shqipëri dhe luftën e vëllezërve tanë, që jetojnë në trojet e tyre, për liri, vetëvendosje e bashkim kombëtar", shkruan Parllaku.

\* Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit

## AKTUALITET

*Përmbillet me sukses stërvitja shumëkombëshe me një ceremoni të veçantë*

# “Defender Europe 25” - Forcat shqiptare, rol kyç në zbatimin e skenarëve stërvitorë

**O** 9 qershor 2025 - Stërvitja shumëkombëshe “Defender Europe 25” u përmbillet me një ceremoni të veçantë, të organizuar në Ditën e Vizitorëve të Shquar.

Në këtë aktivitet morën pjesë personalitete të larta nga Shqipëria dhe partnerët ndërkombëtarë, mes të cilëve shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, e ngarkuara me punë e SHBA, znj. Nancy Van Horn, zëvendësministri i Mbrojtjes z. Enkelejdi Joti, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, gjeneral brigade LaPoint, gjeneral brigade McKinney si dhe komandantë të forcave e anëtarë të komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare.

Të ftuarit ndoqën disa nga demonstrimet e trupave në kuadër të kësaj stërvitjeje, që është një ndër operacionet më të rëndësishme për forcimin e sigurisë kolektive në rajonin euroatlantik.

Në fjalën e tij përshëndetëse, gjenerallejtënant Arben Kingji vlerësoi lart angazhimin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe kontributin e aleatëve në realizimin me sukses të objektivave të përbashkëta. Ai theksoi se pjesëmarrja aktive e FA, me trupa, mjete dhe infrastrukturë, përbën një tregues të qartë të profesionalizmit dhe gatishmërisë së tyre për të përballuar sfidat e mjedisit të sigurisë bashkëkohore.

“Ky bashkëpunim i vazhdueshëm është një dëshmi e qartë e partneritetit strategjik dhe e përkushtimit

• *Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji:*

• *“Defender Europe - 25” konfirmoi edhe një herë angazhimin e palëkundur të Shteteve të Bashkuara si aleat strategjik në forcimin e sigurisë rajonale dhe euroatlantike”*



të ndërsjellë për forcimin e sigurisë rajonale dhe euroatlantike. Stërvitja testoi në kohë reale gatishmërinë, ndërveprueshmërinë dhe kapacitetet reaguese të forcave pjesëmarrëse, si dhe tregoi aftësinë tonë për të mbështetur operacione të përbashkëta në një mjedis kompleks e shumëdimensional”, - u shpreh gjenerallejtënant Kingji.

Stërvitja u zhvillua në disa vende të rajonit, përfshirë Shqipërinë, Kosovën, Kroacinë, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi. Në fokus të veçantë ishte zhvillimi i aftësive për operacione të spektrit të plotë, duke përfshirë dislokimin e forcave, mbrojtjen nga sulme konvencionale dhe jokonvencionale, mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe realizimin e operacioneve të përbash-



këta në mjedise shumëdimensionale.

Forcat shqiptare luajtën një rol kyç në drejtimin dhe zbatimin e skenarëve stërvitorë nga rajoni i Zall-Herrit, në bashkëpunim të ngushtë me Shtabin e Brigadës Shumëkombëshe dhe oficerë nga SHBA, Kosova dhe Kroacia.

Gjenerallejtënant Kingji falënderoi në mënyrë të veçantë Komandën e Forcave Amerikane për Evropën dhe Afrikën për zgjedhjen për të tretin vit radhazi të rajonit tonë, si vend mikpritës të kësaj stërvitjeje madhore, duke e cilësuar atë si dëshmi të partneritetit strategjik mes Shqipërisë dhe SHBA. “Defender Europe - 25” konfirmoi edhe një herë angazhimin e palëkundur të Shteteve të Bashkuara si aleat strategjik në forcimin e sigurisë

rajonale dhe euroatlantike,” - nënvizoi ai, duke shtuar se: “përballë kërcënimeve hibride dhe tensioneve rajonale në rritje, përgjigja jonë është e qartë: stërvitje të përbashkëta, ndërveprim operacional dhe partneritet afatgjatë”, - theksoi shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA.

Stërvitja shumëkombëse “Defender Europe ‘25” nisi zyrtarisht 27 maj 2025, kur trupat e Forcës Tokësore shqiptare u nisën në orët e para të mëngjesit të kësaj dite, nga garnizoni i Zall-Herrit drejt Qendrës së Stërvitjes në Bizë, duke shënuar fillimin zyrtar të stërvitjes së përbashkët “Defender Europe ‘25”.

Kjo stërvitje ndërkombëtare, një nga më të mëdhatë dhe më komplekset e dekadës së fundit në Evropë dhe Afrikë, u zhvillua nën udhëheqjen e Komandës Evropiane të SHBA (EU-COM), në bashkëpunim të ngushtë me vendet aleate dhe partnere të NATO. Shqipëria, si një nga vendet pritëse kryesore, luajti një rol strategjik në garantimin e suksesit të operacioneve dhe zhvillimeve të planifikuara.

“Defender Europe ‘25” synoi rritjen e ndërveprimit mes forcave të armatosura aleate, forcimin e gatishmërisë ushtarake dhe aftësive për të reaguar shpejt ndaj çdo kërcënimi të mundshëm në hapësirën euroatlantike.

Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë ua ngazhuan për të siguruar një mjedis operacional të suksesshëm dhe për të kontribuar në mbrojtjen kolektive, stabilitetin rajonal dhe paqen ndërkombëtare.

## 83-VJETORI

## Në festën e Çetës së Gorë-Oparit

**Ing. Maksim VINÇANI**  
Nënkretar i OBVL

**N**ë datën 22 qershor në Lozhan të Krahinës së Gorës të Bashkisë Maliq u mbledhën gorarët e oparakët në takimim e përvitshëm të festës së tyre lokale...

Kjo toka jonë ka lindur gjithmonë burra, të cilët për qëllimin kombëtar kanë lënë mënjane qetësinë dhe detyrimet familjare, kanë shkruar pasurinë e tyre, deri dhe jetën e kanë dhënë. Si kudo në trojet shqiptare, edhe në krahinën tonë, ato përpjekje, ato ngjarje dhe veprimtari si ato të Kapedanëve të Gorës dhe luftëtarëve të tyre, dhe sidomos periudha e Luftës Antifashiste, janë pjesë e pandarë e historisë së gjithë popullit tonë, janë pjesë e identitetit tonë kombëtar. Dhe populli ynë i ka përjetësuar këto ngjarje, luftëtarët,

• *Duke përkujtuar dhe nderuar ngjarjet e spikatura, luftëtarët dhe dëshmorët, iu përcjellim brezave një mesazh të qartë shembullit dhe krenarie për sakrificat dhe arritjet e Ushtrisë Partizane, por edhe mësimin, që nëse e kërkon prap situata, populli patriot do ta përsërisë sa herë të ketë nevojë Atdheu...*

protagonistët dhe dëshmorët në kujtesën e tij nëpërmjet këngëve apo në tregimet gojë më gojë në dhomat apo kuvendet e burrave brez pas brezi, si nxitje për t’u marrë shembull nga pasardhësit e që të edukohen me krenarinë për herojtë e tanë dhe me dashurinë për këtë tokë. Por që këto të ruhen edhe në kohët më të largëta, nevojiten dhe veprimtari festive përkujtimore si kjo traditë e gorarëve, oparakëve, ku përkujtojmë e nderojmë 83 vjetorin e formimit të Çetës së Gorës-1 më 15 Qershor 1942 në vendin e quajtur “Lajthi e Kolanecit”.

(Vijon në fq 11).



## DOSSIER

U krijuan tre batalione me luftëtarë. Komandantë batalionesh ishin Sylço Beg Bushati, Hamit Gjybegu dhe Taip Shkodra

# LUFTA E KOPLIKUT dhe heroizmi masiv i luftëtarëve malsorë



Nga Sakip Cami

Serbia dhe Mali i Zi nuk donin të pajtoheshin me vendimin e Fuqive të Mëdha për kufijtë e vitit 1913. Ata donin të gllabëronin edhe pjesë të tjera të Dibrës dhe të Shkodrës. Malaziasit shprehnin hapur thirrjen: "Nga Miloti në Kotor gjithçka asht Cerna Gor".

Shkodra ishte dëmtuar shumë nga Lufta e parë Botërore dhe fuqitë e mëdha si Austro - Hungaria, Franca, Serbia e Mali i Zi. Francezët nuk deshën ta dorëzonin Shkodrën te shqiptarët, por Ahmet Zogu, ministri i brendshëm i qeverisë së dalë nga Kongresi i Lushnjës me shokët e tij, pasi i lanë fuqitë e armatosura në Bahçallëk, hynë në Shkodër, duke e bërë fakt të kryer. Shkodranët, të armatosur u gdhinë në pozicione luftarake, duke bërë roje për të evituar ndonjë sulm të papritur të malazezëve. Francezët, më në fund, ikën dhe Shkodra u muar në dorëzim. Ushtria Serbo-Kroato-Malazeze nga mali i Taraboshit sulmoi qytetin e Shkodrës, i cili kishte organizuar rezistencën ndaj saj. Ndaj popullsisë shqiptare në zonat kufitare organizuan një genocid të pashembullt, duke i detyruar shqiptarët të largoheshin me rrobat e trupit drejt Shqipërisë.

Por në zonën e Kelmendit ndodhi një incident që nuk duhet të ndodhte. Në vend që shqiptarët e Hotit dhe Grudës të priteshin si vëllezër e t'u hapeshin kufijtë, ndaj një grupi të larguarish u hap zjarr si të ishin armiq. Kjo ndodhi me 26 korrik 1920. Rojet jugosllave qëlluan ndaj tyre. Forcat e xhandarmërisë shqiptare e tejkaluan kompetencën e tyre dhe sulmuan rojet jugosllave. Në këtë përpjekje u vra një aspirant shqiptar. Kjo u quajt incident shtetëror dhe u shfrytëzua për sulm të plotë dhe të fuqishëm të armatosuar nga serbo - malazezët. Rojet kufitare jugosllave në pikën e kalimit të fshatit Kastrat veçuan nga rreshti i refugjatëve shqiptarë 80 burra dhe pa asnjë shkak, i vranë në sy të prindërve, grave e fëmijëve të tyre.

Të revoltuar nga ky akt barbar, qindra hotjanë, grudas e kastratas dhe dy kompanitë e xhandarmërisë kufitare shqiptare ju vërsulën vrasësve jugosllavë dhe i ndoqnin deri në afërsitë e

• **Lufta e Koplikut, 26 korrik – 14 shkurt 1921, një luftë e gjatë 7 mujore, u kurorëzua me sukses në saj të heroizmit masiv të luftëtarëve malsorë burra edhe gra, ashtu sikurse thotë edhe kanga popullore: Krisi pushka në Prrua të thatë,-/ Në Koplík kan' ardh' dhe gratë...**

qytetit të Tuzit.

Në përgjigje të këtij aksioni të guximshëm të shqiptarëve, me 27 korrik shtatmadhuria e ushtrisë mbretërore jugosllave përgatiti tre batalione me ushtarë. Pasi thyen qëndresën e dëshpëruar të dy kompanive shqiptare dhe luftëtarëve të mbetur pa mbështetje e municion, pushtuesit jugosllavë dhe bashkëpunëtorët e tyre esadistë arritën në fshatin Vrakë, 8 km larg portave të qytetit të Shkodrës.

Në qytet u dha alarmi. Pazari i Shkodrës u mbyll, çirakët, shëgertët e qindra burra të tjerë iu drejtuan depove të armëve. Duke i zgjedhur vetë komandantët e tyre, vullnetarët qytetarë e fshatarë vrapuan në fushën e Shtojit, ku ishin rreshtuar për luftë 500 vullnetarë nga Postriba, një mijë luftëtarë nga Hoti e Gruda, Plava e Guçia, Kosova e Rrafshi i Dukagjinit etj.

Në ditët e para të muajit gusht, pranë shtabit të mbrojtjes të vendosur në Çesme të Koplikut erdhi Ministri i Brendshëm Ahmet Zogu dhe luftëtari Bajram Curri, ministër pa portofol. Ahmet Zogu e spostoi zyrën nga Tirana në Koplík dhe mori përsipër drejtimin e Shkodrës dhe të luftës. Zëvendësa të tij ishin një përfaqësues mysliman dhe një përfaqësues katolik të qytetit të Shkodrës.

Qyteti e humbi gjallërinë e zakonshme dhe qindra vullnetarë u drejtuan me shpejtësi postave të xhandarmërisë duke u armatosur. Vullnetarët shqiptarë nga Shkodra e rrethinat vraponin drejt fushës së Shtojit të gatshëm për t'u nisur sa më shpejt në front si dalëzotsa të Shqipërisë.

Nga Malsia e Madhe shfaqet trimëria dhe guximi i Smajl Martinit e Bacë Kurtit të Grudës, Çun Mulës, Ded Gjon Lullit, Nikoll Mirash Hasanit e Marash Ucit të Hotit, Sokol Mustaf Bajraktarit, Meto Demës, Abdyl Kurtit, Mem Shabanit, Istref Alisë e Haxhi Metës të Koplikut, Mirash Musës e Ded Hysit të Trieshit, Fasli Gruemirës, Tafil Bishos e Ali Tahirit të Grizhës, Hajdar Hukës së Rrjollit, Mark Loshit të Recit, Ujk Gilës nga Kelmendi, Dod Preçit, Zenel Shabanit e Gjël Vuksanit nga Kastrati, Marash Dashit e Tom Nikës nga Shkreli, Tak Elezit nga Lohë e Poshtme, Bec Tahirit nga Buzë e Ujit dhe të qindra shkodranëve.

Me 29 korrik në Shkodër ishte organizuar një takim i madh, takim i drejtuar nga Ahmet Zogu, ministër i brendshëm, përfaqësues i qeverisë së kryeministrit Sulejman Delvina me qëllim shmangien e rrezikut që i vinte krahinës e qytetit të Shkodrës nga avancimi i pushtimit të trojeve shqiptare të Malësisë Madhe nga ushtria shovene jugosllave... Mbledhja u bë nën "moton" e kushtrimit "Serbët ia behën në Koplík". Revista "Agimi" do ta përshkruente kushtrimin si vijon: "Serbët ia behën në Koplík", ishte fja-

la e mbrame, si një rrufe kumbuese në vesh të Shkodranit ditën e parë të gushtit. Lajmi shungulloi e mori dhenë e kushtrimi u dha and e kand ndër fusha e male. Burra të pjekun, djelm të ri, musliman e të krishtenë, si bijtë e thjeshtë të një rrace, vllazën të një gjaku, të një fisi, të një votre e të një zjermit, shqiptarët kurdoherë, ma tepër se shqiptarë përpara të shejtit Atdhe, me vrap me guxim mbyllen dugajë e zyra, lanë ç'do punë e shërbim e menjëherë rrokën armët, tue pasë zjermin në gji e uzdajën në zemër. Burra e djelmë, sot o kurrë... Shka asht mashkull nuk shifet ma në shtëpi, po grumbullohej jashtë në potologun e trimnisë, në fushë të nderit..."

Me 30 korrik në qytet u dha kushtrimi. Vetë Sylço Begu doli lagje më lagje me rekrutua vullnetarë "Nji pushkë për shtëpi". U mbyll pazari. Si në qytet dhe në fshat filloi organizimi i formacioneve vullnetare, gatishmëria e popullit që e plotë dhe e menjëhershme.

Agjuntura serbe bani çmos për me përhapë panik e mosbesim në masën qytetare, por zanet e elementëve të gënjem u mbytën nga vendosmeria e përgjithshme.

Me 1 gusht 1920, paradreke, u nis formacioni i parë me 500 vullnetarë nga qyteti. Me ta u bashkuan edhe malësorët e Mbishkodrës si dhe emigrantët podgoricanë. Ushtria zuri vend përkatësisht në Vrakë. Shtabi zuri vend në Vrakë. Përveç Sylço Begut e Rexhep Shalës në shtab ishin të pranishëm edhe Maliq Bushati, Muharrem Kazazi, Shuk Gurakuqi, Can Mema.

Shtabi do të ndihmohej vazhdimisht në punën e tij nga prania e Ahmet Zogut, Bajram Currit dhe Mustafa Krujës e korrierve të tyre. Kështu, më 1 gusht 1920, dymijë e dyqind luftëtarë shqiptarë, të ndarë në tri kolona, nën komandën e kapitenëve Hamit Gjylbegu e Taip Shkodra, si dhe të prijësit popullor gjashtëdhjetëvjeçar Hasan Ferri nga Plava, u nisën në drejtim të Koplikut të Poshtëm, Çezmës dhe Koplikut të Sipërm. Banda muzikore e qytetit të Shkodrës e drejtuar nga mjeshtëri Frano Ndoja ishte ajo që në vitin 1920 i priu vullnetarëve që shkuan në luftën e Koplikut. Pas një beteje të përgjakshme, forcat shqiptare i sprapsën trupat jugosllave dhe esadistë në vijën e frontit nga Përroi i Thatë deri në Koplíkun e Sipërm. Me 21 gusht të vitit 1920 forcat jugosllave, herët në agim, nisën sulmet me artileri kundrejt kufijve shqiptarë. Brenda disa orëve serbët dhe malazezët kaluan Qafën e Podgoricës dhe përmes marshimit të shpejtë në brinjët e malit të Veçikut, mundën të dalin në malësitë e Shkrelit. Në Shkrel dërgohet një prej oficerëve më besnik të qeverisë, Rexhep Shala, në krye të 300 vullnetarëve të Shkodrës. Fshatarët vetëarmatosen. Ata blenin një pushkë me çmimin e

shtatë dhive të vathës së tyre të vogël. Por kjo forcë nuk mund të përballonte dot rreth 1000 trupa jugosllave të armatosur mirë dhe të ndihmuar nga artileria si dhe të furnizuar mirë me municion e ushqim. Në këtë mënyrë në datat 22 dhe 23 gusht forcat e Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene zunë vijën në fshatrat shqiptarë Kastrat, Shkrel, Koplík e Kelmend.

Nga qyteti i Shkodrës kishin ardhur në frontin e luftës 459 vullnetarë dhe 130 xhandarë të komanduar nga Hasan Bushati, ndërsa nga rrethinat kishte 313 vullnetarë që vinin nga Drishti, Boksi, Suma, Sheldia, Shllaku, Temali, Jubani dhe fshatrat e tjerë.

U krijuan tre batalione me luftëtarë. Komandantë batalionesh ishin Sylço Beg Bushati, Hamit Gjybegu dhe Taip Shkodra. Vullnetarëve të Shkodrës me rrethina u prinin:

Shuk Gurakuqi, Muharrem Kazazi, Zef Serreqi, Hamza Kuçi, Qamil Kadri Boksi, Shaqir Omari, Dyl Grizha, Maliq Bushati, Maliq Sokoli, Nok Gjeloshi, Rasim Gjyzezi, Cuf Kuçi, Man Hoti, Dom Loro Caka, Xhemal Bushati, Abdyl Lluja, Pater Ciril Cani, Oso Koplík, Ramo Halluni, Ahmet Bushati, Adem Haxhia e Can Osmani, Vat Sokoli e Prekë Lula. Forcat vullnetare shqiptare luftëtare, sipas disa kronikave të kohës, në fillim përbëheshin nga rreth 2200 veta, të ndarë në tre kolona.

Kolona e parë përbëhej nga forcat e ardhura nga Gruda, Hoti, Postriba e tjerë, me në krye Deli Metën e Adem Haxhinë, Luc Nishin e Vat Marshin e cila kishte për detyrë të marshonte nga fshatrat Gruemirë-Grizhë e në vazhdim rrëzë maleve.

Kolona e dytë, krahu i majtë ishte ajo që veprimet luftarake do t'i kryente nën rrugën kryesore Shkodër-Hani i Hotit, afër bregut të Liqenit të Shkodrës, e këto forca përbëheshin nga vullnetarë kosovarë e malësorë prej Kastratit (ata që kishin mundur të largoheshin para se të pushtoheshin Kastrati) shkoi buzë liqenit. Keto forca komandoeshin prej Hamit Gjylbegut e Hasan Ferri.

Fuqia kryesore me vullnetarë prej qytetit e një grupi xhandarësh vazhdoi si kolona e qëndrës duke ndjekur rrugën automobilistike Shkodër -Hani i Hotit.

Me 1 gusht me porosi të Ahmet Zogut, pranë bashkisë Shkodër ishte krijuar komisioni Përkujdestar i Ushtrive Vullnetare, i cili do të lunate rol të rëndësishëm në furnizimin e frontit të luftës.

Komisioni përbëhej prej 7 vetash: Musa Juka - kryetar i bashkisë, Ndreke Vogli- nënkryetar i bashkisë, Jonus Repishti, Elez Sokoli, Kolë Çoba, Lec Boriçi e Loro Pistulli.

Me shtimin e numrit të vullnetarëve

(Vijon në faqen 5)

## DOSSIER

U krijuan tre batalione me luftëtarë. Komandantë batalionesh ishin Sylço Beg Bushati, Hamit Gjybegu dhe Taip Shkodra

# LUFTA E KOPLIKUT dhe heroizmi masiv i luftëtarëve malsorë

(Vijon nga faqja 4)

komisioni do të zmadhohej e të kthehej në një intendencë me përbërje: Musa Juka , Pjetër Kola , Elez Sokoli , Jonus Reptsishti , Patuk Saraçi , Het Gjyrezi , Zenel Mandiqi , Kolë Gjinaç e Halit Rroji.

Forcave mbrojtse të Malsisë u prinin :

Deli Meta , Luc Nishi , Zef Prel Martini, Palok Traboini, Tom Nikollë Hasanaj , Kolë Maçi-Hot , Gjakë Dodë Preçi , Gjeloç Gjoka , Gjeta Daka , Dedush Marashi -Kastrat , Prekë Cali-Kelmend, Zef Martin Ivezaj dhe Prekë Dedë Gjollaj-Grud , Pretash Zeku Ulaj-Kojë , Vatë Marashi (Vriith) e Kanto Marashi (Zagore)-Shkrel , Nuz Sokol Bajraktari , Tomë Kolnikaj , Keq Sadik Balaj - Reç , Zekë Ujka (Dodç), Bajram Hyseni (Linaj) , Bisho Abdyl Sulaj - Gruemire, Islam Hajdari (Leporosh), Oso Met Beqiraj (Egç-Rrjoll) , Sylo Kurt Selmani (Burgaj-Rrjoll) Selman Bajram Ramcaj (Gruemirë-Çesme) , Smajl Delia e Tomë Dedë Sina -Lohe Siperme, Tafil Bejtja e Qerim Zymeri Kopliki Siperme , Mustaf Bishi -Lohe e Poshtme, ndër-sa Kelmendit i printe "piramida" e gjallë me ne krye Prek Calin me shokët e tij të atdhetarisë Gjon Uçë Bajraktarin , Uçë Turkun, Lucë Mark Gjeloçin, Mark Tomë Pllumajin, Fran Braçaj, Tomë Bikaj, Mirash Gjoken , e tjerë , që qendronin në mbrojtje të trojeve të veta nga sulmet e herë-pas-hershme të serbo-malazezeve.

Ndërsa Shkodrës me rrethina u prinin:

Sylço beg Bushati, Zef Serreqi , Hamit Gjylbegu , Adem Haxhia e Can Osmani (Postriba), Vat Sokoli (Shalë) , Shuk Gurakuqi , Shan Deda, Muharrem Kazazi, Zef Serreqi , Qamil Kadri Boksi , Dyl Grizha , Maliq Bushati , Maliq Sokoli , Nokë Gjeloçi , Rasim Gjyrezi, Taip Shkodra, Rexhep Shala , Man Hoti, Dom Loro Caka , Xhemal Bushati , Patër Ciril Cani , Oso B. Kopliku.

Në Luftën e Koplikut 1920, për herë të parë ushtria shqiptare aplikoi pengmarrjen e civilëve. Kjo ndodhi në Vrakë ku banonte një komunitet i vogël malazez. Sipas një broshure të botuar nga Gjon Zeka në vitin 1932, i cili ka qenë dhe dëshmitar i këtyre luftimeve "Rrugës çetat shqiptare ndeshën së parit në tre malazez, pak përtej Vrakës, të cilët u vunë me qindrue, por pushka e shqiptarit i shtrini për tokë, tue lanë trupin e tyne pa vorrue për tri ditë si shembull për tjerë, që ushqejshin ndjesi sllave, e këto ndjesi u mudojshin me i zbulue nëpërmjet sa "kryengritjesh" e gjaqesh që banë. Vraça, që ishin me shpirt kah ana e anmikut, me të shpejtë çojnë njerzë me u diftue serbëve planet e luftës dhe sasinë e ushtrive shqiptarëve. Për këtë punë u kujtuan shpejt shqiptarët dhe mblodhen Vrakën tue i marrë ka pesë rob për lagje, si një peng deri mbas luftës, e se vrakaçorët nuk kishin për t'iu ndihmua anmiqëve të vendit tonë".

Edhe gratë shkodrane morën pjesë në luftë krahas burrave.

Me datën 3 gusht u krijua Komiteti Bamirës "Gruaja Shqiptare" me kryetare Shaqë Çobën, nënkryetare Age Kokën, kryetare nderi Habibe Bekteshin, sekretare Paulina Leken, arkëtare Albina



Ashikun dhe anëtare bashkëshortja e Hoxhë Kadrisë, bashkëshortja e Rauf Begut, bashkëshortja e Fahri Begut, Zina Ashiku, Çia Dajçi, Kushe Kadarja dhe Tina Gurakuqi etj. Gratë luftëtare filluan të mblidhin ndihma dhe t'i çonin në front.

## VEÇORI E KËSAJ LUFTE ISHTE EDHE PJESËMARRJA E CIKLISTËVE NË NDIHMË TË LË VEPRIMEVE LUFTARAKE.

Të rinjtë shkodranë krijuan grupin e ciklistëve-korrierë me Simon Rranxin, Muhamet Haxhian, Loro Nikën, Qazim Mesin, Gaspër Dabedakun, Kol Çunin e shumë të tjerë që morën dhe dërguan lajme e posta nga fronti.

Doktor Sadetini organizoi shoqatën e mjekëve dhe infermierëve për të ndihmuar të plagosurit. Farmacisti Ndoc Ashiku ndihmoi me ilaçe dhe veshmbathje për të plagosurit.

Musa Juka, kryebashkiak i Shkodrës dha një kontribut të çmuar për këtë luftë.

Në Shkodrën e mbetur me 20.000 banorë përditë mblidheshin ndihma për 4.000 luftëtarët e ardhur nga Kosova dhe mbarë Shqipëria.

Çdo ditë nga Buna niseshin barka me ushqime, ujë, municione dhe ilaçe që shkarkonin në Grizhë dhe Dobër. Njëkohësisht niseshin edhe karroca me ndihma në rrugë toksore.

Në funksion të kësaj lufte dha një ndihmesë të madhe monetare edhe Xhelal Pashë Bushati, trashëgimtari i fundit i Pashallëkut të Bushatllinjve.

Forcave mbrojtëse të Malësisë u prinin Deli Meta, Luc Nishi e Zef Prel Martini, Gjok Dod Preçi, Zenel Shabani, Smajl Shabani, Gjeloç Gjoka, Gjeta Daka e Dedush Marashi, Zef Martin Ivezaj dhe Prek Ded Gjollaj, Vat Marashi e Kanto Marashi, Nuz Sokol Bajraktari, Keq Sadik Balaj, Bajram Hyseni, Bisho Abdyl Sulaj, Islam Hajdari, Oso Met Beqiraj, Selman Bajram Ramcaj, Smajl Delia e Tom Ded Sina , Tafil Bejtja e Qerim Zymeri, Mustaf Bishi e të tjerë në krye të fshatrave të tyre.

Në formacionet luftarake të kësaj lufte bënin pjesë edhe treqind luftëtarë vullnetarë nga Kosova dhe Plava e Guçia. Këtyre trimave u printe Hasan Feri, djali i Jakup Ferit. Në javët e para të gushtit erdhën në Shkodër edhe rreth

treqind vullnetarë nga Kruja, Shijaku, Durrësi e Tirana, të cilëve u prinin Abaz Kupi e Mustafa Merlika (Kruja).

Në Shkodër qëndronin në mbrojtje të qytetit e rrethinave qindra luftëtarë të tjerë , ku rreth dyqind e gjashtëdhjetë vullnetare vinin nga Kosova, Hasi, Kukesi, Tropoja e nga vise të tjera. Në këto kohë Dukagjini ishte i tëri në kembë në mbrojtje të trojeve të veta nga invazionet e ushtrisë Sërbo-Malazeze. Edhe Lezha, Mirdita, Puka e qëndronin në gatishmëri të mbrojtjes së trojeve shqiptare.

## RËNIA HEROIKE E TRIMIT ZEF PRELË MARTINI, OSO KUKA I RI

Beteja luftarake të dates 20 shtator 1920, ku trimi hotjan Zef Prelë Martini, i plagosur gjatë luftimeve detyrohet të "ngujohet" në Llazan në shtepinë e Lush Pepë Smakajt (me origjinë nga fisi Ivezaj të Grudës), i cili pa hezitim, siç e kanë pasur traditë malësorët ja lënë Zefit shtepinë e tij për ta kthyer në një kullë baroti që do ti ngjante asaj të Oso Kukës në Vraninë të shek.XIX.

Nga kjo shtëpi-kullë, Zef Prelë Martini i rrethuar, do të luftonte trimërisht e heroikisht për orë të tëra kundër ushtrisë serbo-malazeze , duke vrarë katër ushtarë e një oficer armiqë e plagosur të tjerë. Për të kapur të gjallë Zef Prelë Martinin e plagosur, serbo-malazezët përdorin dredhinë e një majori shqiptar , shërbëtor në ushtrinë serbo-malazeze, ku pas dorzimit në besë të pabesëve, ata e vrasin në Badër të Mehajve-Koplik, aty ku edhe sot ka një memorial kushtuar këtij heroi.

Beteja që nënshkroi disfatën e turpshme të serbo-malazezëve ishte ajo që u zhvillua në Badra të Koplikut.

Kodra e Bajraktarit ishte pikë dominante në Koplik, pranë saj kishte dhe një pyll të dendur. Kush mbante atë kodër kishte në shuplakë të dorës tërë fushën e Koplikut dhe Buzë Ujit. Aty spikati trimëria shkodrane dhe vetmohimi malsor që të gërshetuara të dyja bashkë e shndërruan këtë luftë në epike të paharruar. Fronti i luftimeve ishte i gjërë, nga Buza e Ujit deri në Marshej, ku u përdor edhe artileria. Topat serbo-malazezo-kroat ishin vendosur në njerën faqe të Prroit të Thatë dhe qëllonin kundër forcave shkodrane duke i penguar për-

parimin e mëtejshëm. Bajraktari i Hotit, Deli Meta së bashku me të vëllain dhe disa hotjanë iu afrua natën baterise së artilerisë, vranë rojet dhe i rrëmbyen të gjithë topat. Deli Meta, një luftëtar nga çeta e Shkrelit që kishte shërbyer si artiler në ushtri e vuri në përdorim baterinë e vogël të topave.

Forcat shkodrane e morën para armikun nga Sukat e Dobrës, në Koplik dhe në zallin e Badravet pati disa orë luftime ku forcat serbo-malazeze lanë në fushë-betejë rreth gjashtëqind të vrarë dhe ikën nga sytë këmbët. Luftëtarët shkodranë e ndoqën armikun deri në Prua të Thatë ku u zhvilluan luftime sporadike. Të nesërmen luftimet vazhduan përsëri deri në Suka të Moksetit derisa u dëbuan përtej kufirit.

Gjatë luftimeve, kosovarët e kishin pozicionin në kodrën që quhej Kodra e Bajraktarit. Ishin katërqind luftëtarë. Me kosovarët ishin edhe dyqind kru-tanë.

Prekë Cali së bashku me Hamëz Kuçin, Hamid Gjylbegun, Dodë Nikollën etj., kanë luftuar për ditë e netë të tëra në frontin më të vështirë duke u përleshur me forcat pushtuese jugosllave.

Betejat mbrojtëse të shqiptarëve, në luftën mbrojtëse kundër ushtrisë shovene serbo-malazeze vazhduan deri me 14 shkurt 1921, kur ushtria shovene serbo-malazeze u detyrua të tërhiqet në kufirin e vitit 1913.. Mbetën në altarin e lirisë dhe të mbrojtjes së atdheut Kadri Selmani, Cuf Brahimi, Dylo Meti, Zeqir Hoti, Bel Cufaj, Nikoll Zefi, Brahim Sejdi, Dik Laçi, Hajdar Meta, Beqir Curri, Cul Istrefi, Sejdi Fili, Hajdar Curri, Musa Selimi, Bajram Rexha, Hajdar Duli, Zek Zeneli, Sylo Haxhia, Beqir Zeneli, Ramadan Sejdi, Çun Zeqiri, Abdyl Bajraktari, Cuf Rexhepi , Elez Ujka, Prekë Zefi dhe Fran Rroku i cili ishte edhe kryeplak i Koplikut në ato vite etj., të cilët u bënë legjenda e luftës së Badrave të Koplikut, legjendë që zuri faqet e para të gazetave të Europës. Barrën kryesore të kësaj lufte e mbajti Malësia e Madhe, jo vetëm se fronti kryesor i luftës kundër shovenëve serbo-malazez ishte në trojet e Malësisë, në vijim të traditës shekullore në mbrojtje të trojeve shqiptare. Në frontin më të vështirë të kësaj lufte qëndronte Hoti, Kastrati dhe e gjithë Malësia e më gjërë.

Nga një dokument i kohës mësohet lista e ushtrisë vullnetare të organizuar , Malësi e Madhe -Shkodër, si vijon: Rapsa e Hotit 120, Traboini 103, Gruda 32, Kastrati 307, Shkrelit 148, Rrjollit 113, Buza e Ujit 34, Reçi e Lohja 132, Drishti 76, Boksi 76, Suma 32, Kosova 160, Grizha 76, Kopliku 30, Sheldia 24, Shllak e Temal 90, Jubani 15, Xhandarë të Hasan Bushatit 130, Parruca 36, Perashi i Vogël 22, Dudasi 10, Rus i Vogël HM 29, Rus i Madh 18 , Rus i Vogël (S) 58, Rus i Vogël (N) 63, Qafa 10, Tophana 35, Ndocej 23, Rus i Madh (përsëri) 52, Bahçallek 10, Katolikët e Shkodrës 72, Hylli i kuq 6, Xhibali 1568 vullnetarë.

Në këtë luftë dhanë jetën 77 dëshmorë , nga të cilët 62 nga Malësia e Madhe me Rranxat e saja, 14 nga Shkodra e Postriba dhe 1 nga Dukagjini, si dhe u plagosen dhjetra malësorë , shkodranë e tjerë...

## KUMTESA

*Skënderbeu është emri më i nderuar, më i respektuar dhe më i dashur për gjithë shqiptarët, kudo që jetojnë*

# Karakteri atdhetar i luftërave të Skënderbeut, themelues i shtetit të parë kombëtar shqiptar

Prof. ALI HOXHA

**B**urrë shteti shqiptar, më i madhi i të gjitha kohërave është, pa dyshim, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, themeluesi i shtetit të parë kombëtar shqiptar.

Skënderbeu është emri më i nderuar, më i respektuar dhe më i dashur për gjithë shqiptarët, kudo që jetojnë dhe i tillë, ky emër do të jetë i nderuar për jetë të jetëve, sa kohë që do të ekzistojë në këtë botë kombi shqiptar dhe emri shqiptar, sepse emri i Skënderbeut është simboli numër një i kombit tonë; me emrin e tij lidhet krijimi i shtetit të parë kombëtar shqiptar, ndaj edhe flamuri i Skënderbeut është flamuri kombëtar shqiptar, i shtetit të Shqipërisë dhe i gjithë shqiptarëve në Kosovë, i atyre në trojet e veta në Maqedoni e në Mal të Zi, si dhe i atyre që jetojnë kudo, në diasporë.

Skënderbeu, gjenerali më i ri dhe më i lavdishëm i Perandorisë osmane, në kohën e vet, 582 vjet më parë, në nëntor të vitit 1443, i nxiti nga ndjenja e atdhedashurisë, për gjakun dhe trullin e të parëve të vet, thënë ndryshe, për ruajtjen e identitetit të vet, braktisi jetën luksoze, përrallore që bënte në oborrin e Sulltanit të superfuqisë më të madhe botërore të kohës së vet dhe, kur iu krijuan kushtet dhe rrethanat, në momentin e përshtatshëm për të, u kthye në Shqipëri, i shoqëruar nga 300 dibranë besnikë të tij ku, pasi çliroi, së pari, Dibrën dhe më pas Krujën, më 28 Nëntor 1443, në Kështjellën e Krujës valëviti i lirë Flamuri i Skënderbeut dhe i Principatës së Kastriotëve, Flamuri i Kuq me shkabën e zezë dy krenare, që më pas u bë flamuri kombëtar i gjithë Shqipërisë dhe i gjithë shqiptarëve kudo që jetojnë.

Më pas, në një kohë rekord, vetëm prej tre muajsh, Skënderbeu arriti bashkimin e të gjitha principatave shqiptare në Kuvendin ose Besëlidhjen e Lezhës, me 2 Mars 1444, ku Skënderbeu u zgjodh njëzëri kryekomandant i Përgjithshëm i ushtrisë së bashkuar kombëtare shqiptare, duke sanksionuar kështu de facto dhe de jure krijimin e shtetit të parë kombëtar shqiptar.

## FRYMËZUES I POPULLIT SHQIPTAR NË TË GJITHA KOHËRAT

Emri i Skënderbeut u bë një simbol që e ka frymëzuar popullin shqiptar në të gjitha luftërat e tij qindra vjeçare kundër të gjithë pushtuesve të huaj. Në këtë aspekt edhe rilindasit shqiptar në të gjithë luftërat dhe përpjekjet e tyre për liri dhe pavarësi, jo vetëm që janë frymëzuar dhe udhëhequr nga emri dhe shembulli i Skënderbeut, por edhe shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1912, e ideuan dhe e realizuan më 28 Nëntor, pikërisht në të njëjtën datë, në të cilën e pat shpallur Skënderbeu për herë të parë në 1443. Ndaj një skenar filmi që ia kushtoi shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 28 Nëntor 1912, shkrimtari Ismail Kadare e ka quajtur me të drejtë, “Nëntori i



dytë”. Edhe çlirimi i Shqipërisë prej pushtimit nazi-fashist në vitin 1944, u projektua dhe u realizua nga luftëtarët e lirisë pikërisht me 28 Nëntor, kur qeveria demokratike hyri në Tiranë, që të ishte në unison me dy 28 nëntorët e parë.

Për figurën e Skënderbeut, tash 600-vjet me radhë, shumë autorë, shqiptarë dhe të huaj, kanë shkruar shumë libra e studime të veçanta shkencore dhe artistike, shumë filma artistikë e dokumentarë janë bërë për të, shumë piktura e kompozime muzikore i janë kushtuar këtij kolosi, shumë përmendore janë ngritur për të, jo vetëm në trevat shqiptare, por edhe në sheshet qendrore të shumë kryeqyteteve të shteteve të Europës dhe të Amerikës, pa u ndalur këtu në emrin e tij që u është vënë ndërmarrjeve dhe institucioneve të ndryshme si, shkollave, shesheve, rrugëve, skuadrave sportive, firmave ekonomike, prodhimeve industriale etj.

Nisur nga aspekte e qëllime të caktuara pragmatike, pse jo edhe politike, shumë autorë të ndryshëm, kryesisht të huaj, në shkrimet e tyre kanë bërë edhe spekulime të qëllimshme deri edhe në mohimin e origjinës shqiptare të Skënderbeut, deri në absurditet, me synimin për të vjedhur e përvetësuar edhe figurën e tij, duke e shpallur Skënderbeun dikush me origjinë serbe, apo dikush tjetër në grek. Ky spekulim e ka një shpjegim, pasi bëhet fjalë për atë periudhë të mesjetës kur sapo kishte filluar krijimi i shteteve të reja në ballkan dhe fqinjët shovinistë përpiqeshin të rrëmbënin sa më shumë jo vetëm nga trojet shqiptare, por mundoheshin që të përvetësonin edhe herojtë dhe historinë e shqiptarëve.

Por, ajo që duhet të theksojmë këtu, është fakti se kohët e fundit kanë dalë

edhe disa autorë të huaj si Shmidt-etj, apo edhe ndonjë vendas, nënshtetas shqiptar por me gjak (origjinë) të përzier, të cilët për qëllime të caktuara pragmatike apo ndoshta edhe të nxitur nga qarqe të caktuara politike, nga brenda apo nga jashtë vendit, që me ndonjë libër të tyre kanë tentuar të denigrojnë figurën e Skënderbeut (siç është, p.sh. libri i B.Blushit).

Por ajo që dua të nënvizoj këtu është se si kjo kategori, ashtu edhe ndonjë autor tjetër i asaj kategorie, të cilët, duke mos pas kulturën e mjaftueshme historike, apo thjesht për të bërë emër, kërkon të sjellë origjinën e Skënderbeut nga fshati i vet, e pse jo, mundohet ta identifikojë edhe me fisin e vet, më e pakta që mund të themi për ato kategori autorësh, është se ata janë të atillë që, edhe pse shkojnë me ndërjegje kundër rrymës, kundër së vërtetës, mjafton që me këtë mënyrë ata t'i bëjnë publicitet emrit të vet, për të hyrë në bibliografi si autorë që kanë shkruar për Skënderbeun, pavarësisht se çfarë kanë thënë, dhe sa i shërbejnë së vërtetës ose jo, apo nëse i lexon ndokush apo jo.

Lidhur me sa më sipër se, për atë kategori autorësh që nuk kanë kulturën e mjaftueshme historike, përmend këtu, se Instituti i Historisë i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë ka botuar, qysh në vitin 1989, një përmbledhje studimesh nga autorë shqiptarë dhe të huaj, në tre vëllime, me titull “STUDIME PËR EPOKËN E SKËNDERBEUT”, nga vëllimi i dytë i të cilit, theksoj këtu studimin e autorit nga Kosova, Flamur Hadri, me titull: “Historiografia shqiptare mbi personalitetin e Skënderbeut, origjinën dhe rininë e tij”. Në të njëjtën kohë i kujtojmë lexuesit se lidhur me origjinën dhe jetën e Skënderbeut, materiale më të bollshme gjen në veprën e akademi-

• *Skënderbeu, si strateg e diplomat i madh, në luftën e tij atdhetare legjendare kundër superfuqisë më të madhe të kohës, ishte e natyrshme që duhej të kërkonte edhe aleatë të jashtëm. Në një kohë kur e gjithë Lindja islame ishte e pushtuar nga Perandoria osmane, ishte e natyrshme që Skënderbeu të kërkonte aleatë në Perëndim, duke shfrytëzuar rrethanat e kohës, konjunkturat e kohës, por kjo nuk do të thotë aspak se Skënderbeu në vepërimtarinë e tij të gjithanshme paska pas një “qëndrim të premë në favor të Perëndimit të krishterë...”*

kut Kristo Frashëri, kushtuar jetës e veprës së Skënderbeut. (Tiranë 2002, fq.54-56, me titull “Nga ishin Kastriotët”).

Por vula e të gjitha studimeve për origjinën e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut është deklarata e Gjon Muzakës, bashkëkohës, bashkëluftëtar dhe mik (me krushqi) i Skënderbeut:

“Ta dini se gjyshi i Skënderbeut quhej Pal Kastrioti dhe se ai kishte në pronësi të tij vetëm dy katunde në Dibër të Poshtme, Sinën dhe Gardhin e Poshtëm.”

## SANKSIONIMI I ORIGJINËS DIBRANE TË KASTRIOTËVE

Përfundimisht origjina dibrane e Kastriotëve është sanksionuar nga Instituti i Historisë i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë më 1985 kur u inaugurua Muzeu historik i Kastriotëve në Sinë të Çidhnës, në Dibër të Poshtme.

Për çlirimin dhe mbrojtjen e atdheut të vet, Shqipërisë, Skënderbeu zhvilloi dhe drejtoi 30 beteja për 25 vjet me radhë, prej të cilave fitoi 29 beteja kundër ushtrive të Perandorisë osmane, superfuqisë më të madhe të asaj kohe, ndërsa humbi vetëm një betejë, por edhe këtë vetëm për shkak të tradhtisë nga brenda (“Tirana Observer”, datë 11 janar 2008, f. 19).

Lidhur me vlerësimin e figurës së Skënderbeut, mjafton të përmendim vetëm një fragment nga kërkesa e dy senatorëve amerikanë, Dana Rohrabacher dhe Tom Lantos, që paraqitën për një rezolutë në Kongresin amerikan të SHBASë në shenjë nderimi dhe përkujtimi për 600 vjetorin e lindjes së Gjergj Kastriotit – Skënderbeut: “Sipas gjeneralmajorit James

(Vijon në faqen 7)

## 81 VJETORI

*Skënderbeu është emri më i nderuar, më i respektuar dhe më i dashur për gjithë shqiptarët, kudo që jetojnë*

# Karakteri atdhetar i luftërave të Skënderbeut, themelues i shtetit të parë kombëtar shqiptar

(Vijon nga faqja 6)

~olfe, komandanti i ushtrisë britanike në Kuebek, "Skënderbeu ua kalon të gjithë oficerëve të lashtë dhe të kohëve moderne, në drejtimin e një ushtrie të vogël ofensive" dhe ... Sipas historianit britanik, Eduard Gibon "Entuziazmi i kalorësisë dhe religjionit e kanë renditur princin shqiptar përkrah Aleksandrit të Madh dhe Pirros" (cituar sipas gazetës "Tema", dt. 4 nëntor 2005, f. 9).

Nisur nga fakti i pozicionit gjeografik të Shqipërisë, ashtu siç përcaktohet në rezolutën e lartpërmendur, me luftën e tij për liri, "populli shqiptar, nën udhëheqjen e Skënderbeut, parandaloi rënien e Romës dhe të Italisë në sundimin e Perandorisë otomane, duke i rihapur kështu rrugën Rilindjes-Renecencës italiane".

Por ajo që më nxiti të bëj këtë shkrim është fakti, se kanë tërhequr vëmendjen disa mendime të ndryshme të shprehura kohë më parë në shtypin e përditshëm lidhur me figurën e Skënderbeut, ku kanë bërë analiza subjektive, të cilat janë jo vetëm shumë larg të vërtetës historike, por të nisur nga qëllime të caktuara pragmatiste, apo për konjuktura të caktuara politike, kanë arritur aq larg, sa të mohojnë edhe karakterin atdhetar të luftës legjendare të Skënderbeut. Ata kanë shtrembëruar të vërtetën historike, sikur Skënderbeu, gjoja, paska luftuar për të mbrojtur krishterimin perëndimor, apo Skënderbeu ka qenë atlet i Krishtit etj. Pa dashur të hyjë në polemikë me askënd, po përmend shkrimin me titull "Orientimi katolik i luftës së Skënderbeut..." të Dr. Sami Repishtit, botuar në gazeta "Tema", të datës 21 nëntor 2005, f. 19, ku, ndër të tjera, shkruhet: "Figura poliedrike e Skënderbeut, sundimtar, diplomat, strateg ushtarak dhe mbrojtës i krishterimit perëndimor mbetet gjithherë epiqendër e krijimtarisë kombëtare shqiptare dhe personalitet qendror që bashkoi dhe vazhdon të bashkojë shqiptarët, brenda dhe jashtë Shqipërisë, pa dallim feje, krahine dhe ideologjie politike". Dhe, më tej, vazhdon: "I lindur në një vend si Shqipëria, kurdoherë një urë midis Lindjes dhe Perëndimit, veprimtaria e gjithanshme e Skënderbeut karakterizohet nga një marrje qëndrimi të premë në favor të njëjës - Perëndimit të krishterë dhe kundër tjetrës - Lindjes Islamike, një qëndrim unik në atmosferën politike të Ballkanit në shek. XV".

\Ky mendim, jo vetëm nuk shpreh aspak të vërtetën historike, pasi është një mendim thjesht subjektiv, në kundërshtim diametralisht të kundërt me realitetin historik, por është dhe krejt i pabesueshëm për cilindo lexues që ka, sadopak, njohje dhe kulturë historike. Është i papranueshëm se shtrembëron karakterin patriotik të luftës së Skënderbeut, kur thuhet "Ori-

entimi katolik i luftës së Skënderbeut". Gjithkush e di se Skënderbeu nuk ka luftuar as për krishterimin perëndimor dhe as për Krishtin, pasi ai ka luftuar në radhë të parë, për lirinë e atdheut të vet me luftërat e tij kundër Perandorisë Osmane, pavarësisht se lufta e tij indirekt ka kontribuar edhe në mbrojtjen e Krishtërimit perëndimor, por kjo kurrsesi nuk do të thotë se lufta e Skënderbeut ka karakter fetar me orientim katolik. Autori i mendimeve të lartpërmendura bie në kontradiktë me vetveten, pasi në qoftë se Skënderbeu do të kishte luftuar për katolicizmin e për krishterimin perëndimor, atëherë ai kurrë nuk do të kishte pasur mbështetjen e përkrahjen e shumicës së popullsisë shqiptare myslimane dhe ortodokse, në gjallërinë e tij (dokumentet historike vërtetojnë se islamizmi i shqiptarëve, në disa treva arriti përmasa të mëdha qysh në kohën e Skënderbeut. "Atëherë, mbi 60 % e banorëve të Shkupit dhe të Manastirit ishin muslimanë" (cituar sipas Kasem Biçokut, në "Tema", datë 2 mars 2005, f. 9), po ashtu dhe pas vdekjes së tij, ithtarët e tij, myslimanë, nuk do ta ngrinin aq lart siç bënë Rilindasit tanë të ndritur Naim Frashëri, Hoxha Tahsim, etj., deri tek Haxhi Vehbi Dibra, ish-kryetar i Senatit të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës dhe kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë që e shkëputi edhe KMSH nga Halifati i Stambollit etj.

## SKËNDERBEU, STRATEG E DIPLOMAT I MADH

Skënderbeu, si strateg e diplomat i madh, në luftën e tij atdhetare legjendare kundër superfuqisë më të madhe të kohës, ishte e natyrshme që duhej të kërkonte edhe aleatë të jashtëm. Në një kohë kur e gjithë Lindja islame ishte e pushtuar nga Perandoria osmane, ishte e natyrshme që Skënderbeu të kërkonte aleatë në Perëndim, duke shfrytëzuar rrethanat e kohës, konjunkturën e kohës, por kjo nuk do të thotë aspak se Skënderbeu në veprimtarinë e tij të gjithanshme paska pas një "qëndrim të premë në favor të Perëndimit të krishterë...", pasi, siç do të theksojmë më poshtë, ai ka luftuar dhe kundër Perëndimit të krishterë. Lidhur me kërkimin e aleatëve në Perëndim nga ana e Skënderbeut, kjo nuk do të thotë aspak se Skënderbeu, luftës së tij çlirimtare e mbrojtëse të atdheut të vet, i paska dhënë karakter katolik. Për analogji mjafton të kujtojmë një moment historik të ditëve tona kur, në vitet 1990-91, ish-Presidenti Ramiz Alia, me emër mysliman por me bindje ateiste, edhe pse në atë kohë ishte në fuqi Kushtetuta e vitit 1976, kur shteti shqiptar ishte i sanksionuar si i vetmi shtet ateist në botë dhe me ligj ndalohej ushtrimi i fesë në Shqipëri, i imponuar nga rrethanat e kohës, u detyrua që të lidhte marrëdhënie diplomatike me shtetin e Vatikanit.



Por kjo nuk do të thotë dhe nuk vërteton aspak që R. Alia të jetë kthyer as në katolik dhe as në mbrojtës të krishterimit, ndoshta as besimtar.

Në këtë aspekt, mendimi ynë përforcohet edhe nga mendimi i z.Vlash Prendi, i cili në studimin e tij "Gjergj Kastrioti dhe Selia e Shenjtë" ndër të tjera shkruan: "Marrëdhëniet e Gjergj Kastriotit me Vatikanin janë pasqyrë e një prej aspekteve më të rëndësishme të personalitetit të tij prej burri shteti dhe diplomati, të lindur në Dibër më 1405 dhe vdekur në Lezhë më 17 janar 1468. Duke qenë se Selia e shenjtë në Mesjetë ishte pushteti qendror i Europës dhe ushtronte autoritetin e saj si mbi aspektet fetare të banorëve të Europës, ashtu edhe mbi të gjitha aspektet e tjera të jetës së tyre, ishte mençuri nga ana e Skënderbeut që të përpiquej të fitonte vëmendjen e Vatikanit dhe ta përdorte për qëllimet e tij. Qysh në fillim duhet theksuar se marrëdhëniet midis Skënderbeut dhe Selisë së Shenjtë u ndërtuan mbi bazën e interesit të ndërsjellë, si nga ana e Skënderbeut ashtu edhe nga ana e Selisë së shenjtë, interesa këto që erdhën duke u forcuar me kalimin e kohës dhe me rritjen e famës së Skënderbeut si strateg në luftën kundër osmanëve". (Vlash Prendi: Papa Kle-

menti XI ..., Gjergj Kastrioti dhe Selia e Shenjtë", "Republika", datë 4 nëntor 2012, fq.14).

Kështu, nisur nga fakti se në një letër përgëzuese që Papa Kaliksiti III (1455-1458), i kishte dërguar Skënderbeut pas fitores së tij në betejën e vitit 1457 në Ujëbardhë kundër ushtrisë turke prej 80.000 vetash, nën komandën e gjeneralit të sprovuar turk Isak bej Evronez, ndër të tjera, ai përdor një shprehje të tillë figurative vlerësuese për Skënderbeun: "Nuk ka njeri në botë që të mos ngrëjë në qiell veprat tuaja me lëvdatat më të larta dhe të mos flasë për fisnikërinë tuaj, si për një atlet të vërtetë në mbrojtje të të krishterëve. (Cituar sipas K. Frashërit, "Skënderbeu, jeta dhe vepra", Tiranë, 2002, f. 484).

Një shprehjeje të tillë figurative, një similitude si ajo e lartpërmendur, e motivueshme dhe e pranueshme për të dalë nga goja e një pape, apo qoftë edhe nga goja e një prifti të kohës së Skënderbeut ose edhe të mëpasshëm, është e pakuptueshme dhe e papranueshme që t'i jepet një interpretim si ai i lartpërmendur, duke shtrembëruar të vërtetën historike, aq më tepër kur autori i tij është një studiues laik i shekullit XXI.

(Vijon në numrin e rradhës)

## PROFILI

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË E KA KONSIDERUAR AKT HEROIK HUMAN DHE VETMOHUES

# MAJOR ELTON MYRKU, U MBYT NË DET PËR TË SHPËTUAR DY JETË

• *Elton Myrku është oficeri i parë shqiptar që ka stërvitur trupat e NATO-s. Si i tillë, në vitin 2010 ai është pjesë përbërëse e kontigjentit tonë ushtarak dhe flamurbajtësi i Flamurit tonë kombëtar në ceremoninë e parakalimit në krye të flamujve të 27 vendeve, me rastin e pranimit të Shqipërisë në NATO*



## Halil Rama – Mjeshtër i Madh

Pesë vjet më parë, pasi kreu me sukses Kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm pranë Akademisë të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, me rezultate të shkëlqyera, major Elton Myrku iu përkushtua për disa ditë fëmijëve, para se ata të fillonin vitin e ri shkollor.

Rrugëtimin për në Lushnjë, për t'i dërguar dy djemtë të gjyshërit nga mamaja, e ndaloi për disa orë në Plazhin e Gjeneralit në Kavajë. Drekojnë dhe pastaj futen në det. Tek po luante me ta, në thellësinë rreth një metër, ku i madhi Roeli 11 vjeç lunate me dallgët, të voglin, Jorikun 3 vjeç e kishte në qafë. Ndërkohë, një djalë rreth 11-12 vjeç në thellëi bërtet e kërkon ndihmë se po mbytej.

Është vërtet tronditës rrëfimi i djalit të madh, Roelit: “Babi me Jorikun në qafë vrapon me shpejtësi. Arrin tek ai dhe e shpëton, duke e afruar që të kapet tek litari i shpëtimit. Pasi bindet se ai e komandonte veten dhe nëpërmjet litarit afrohet në cektesë, kthehet me djalin në një rënë dorë për të dalë në breg, por në momentin e kthimit, një dallgë e fuqishme i përplasat në fytyrë duke e mbuluar”.

Pak a shumë, kështu përshkruhet akti heroik, i major Elton Myrku, që ndërsa kishte shërbyer me devotshmëri për disa vite në emisione paqeruajtëse, si në Afganistan, Irak e Kosovë dhe ishte flamurmabajtësi ynë në ceremoninë e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, u mbyt në det për të shpëtuar dy jetë... Sipas ekspertizës gjyqësore, uji i detit ka depërtuar në diafragmën e frymëmarrjes dhe e ka paralizuar trupin e 41 vjeçarit Elton Myrku, i cili edhe ashtu në vështirësi është përpjekur ta mbajë djalin lartë. Roeli tregon se ka thirrur për ndihmë, por nga të pranishmit në atë plazh është mundësuar vetëm nxjerrja në cektesë e djalit të vogël të cilin e kanë shpëtuar, ndërsa Eltonit, me vonesë i është dhënë ndihma, e kësaj nuk është rikthyer në jetë. Ai shpëtoi dy jetë, duke sakrifikuar të tijën.

Ky akt heroik legjitimohet edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin Nr.12-2021-489/118, datë

30.03.2021, në të cilin theksohet fakti se: “...kemi të bëjmë me humbje të jetës së të ndjerit Elton Myrku, duke u mbytur në det aksidentalisht, pasi me një ndjenjë të lartë qytetarie, ka kryer një AKT HEROIK HUMAN DHE VETMOHUES, duke u shpëtuar jetën nga mbytja në det të dy fëmijëve të mitur, në vendin e quajtur ‘Plazhi i Gjeneralit’ të Njësisë Administrative Synej, Bashkia Kavajë”.

## VLERËSIMI I PRESIDENTIT BEGAJ, KUR ISHTE SHEF I SHTABIT TË PËRGJITHSHËM

“Eltoni ishte një ushtarak e profesionist i zoti, i dashur me shokët e vartësit e tij. Tek ai mbizotëronte ndjenja e sakrificës dhe e vetmohimit ndaj detyrës. Detyra, Nderi, Atdheu për të ishin gjithshka. Ai së bashku me shokët kishte marrë pjesë në disa misione paqeruajtës jashtë vendit, si në Afganistan e Kosovë, duke manifestuar cilësi të rralla në kryerjen e tyre në dobi të paqes dhe sigurisë në botë”, -shkruan ndër të tjera ish-Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA të RSH, Gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj (aktualisht President i Republikës), në telegramin e ngushëllimit për Familjen e të ndjerit Elton Myrku. Nga ky telegram që mban datën 06.09.2020 mësojmë se Eltoni, gjatë karrierës së tij ushtarake, gati 20 vjeçare, kreu me devotshmëri e përkushtim një sërë detyrash komanduese të nivelit të togës dhe kompanisë në Forcat Tokësore, duke shpalosur njohuritë dhe përgatitjen e lartë ushtarake të fituar gjatë studimeve në Turqi, por edhe në kurset e kualifikimit e të trajnimit brenda e jashtë vendit. Për disa vite ai punoi po me të njëjtin përkushtim edhe në Agjencinë e Informacionit dhe Sigurisë së Mbrojtjes. “Eltoni sapo kish përfunduar me sukses Kursin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe priste të fillonte një detyrë të re në përshatje me kualifikimin dhe aftësitë e tij intelektuale dhe profesionale, por vdekja e papritur i ndërpreu në mes karrierën ushtarake, së cilës i ishte përkushtuar që në moshën 14 vjeçare. Ai kish ende ëndrra e plane për jetën e tij, por edhe për familjen, e sidomos për dy djemtë e tij ende të vegjël, por të gjitha këto iu ndërpreu, ashtu krejt papritur, duke

lënë në pikëllim të madh familjen, të afërmit e gjithë shoqërinë e tij ushtarake e civile.

Për shërbimet e shquara në kryerjen e detyrave të ngarkuara Eltoni është vlerësuar me Urdhëra e Medalje të ndryshme ushtarake nga autoritetet më të larta në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të FA”, - shkruan ndër të tjera ish-Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA të RSH, Gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj (aktualisht Presidnet i Republikës).

Nga ky telegram ngushëllimi mësojmë gjithashtu se Elton Myrku, përveçse një ushtarak i zoti e me cilësi tepër të rralla, ishte një bashkëshort i denjë, një prind shembullor, një mik dhe shok i rrallë për të gjithë ata që punuan dhe e njohën nga afër.

Duke i shprehur ngushëllime familjes, ish-Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA të RSH shkruan se “Me vdekjen e Eltonit Forcat e Armatosura humbën një kuadër profesionist të shkëlqyer, prindërit Myrteza dhe Serja djalin e tyre të vetëm, dy djemtë, Roeli dhe Joriku humbën prindin, njeriun më të dashur e të pazëvendësueshëm, bashkëshortja Rodina, njeriun e jetës...”

## ELTON MYRKU, I DEKORUAR EDHE NGA SHEFI I SHTABIT TË USHTRISË TURKE

U lind në Dibër më 22 mars 1979 në një familje me ndjenja të larta patriotike e liridashëse. Pasi kreu shkollën 8-vjeçare në vendlindje me rezultate të shkëlqyera, Elton Myrteza Myrku, me dëshirën e madhe për të qenë pjesë e Forcave të Armatosura, kreu me sukses Shkollën e Mesme ushtarake në Bursa të Turqisë, e në vijim Akademinë e Forcës Tokësore dhe Kursin bazë të Oficerit në Ankara.

Gjatë kohës së shkollimit në Turqi, për shtatë vjet ishte kampion në vrapimin me pengesa, i dekoruar nga Shefi i Shtabit të Ushtrisë Turke. Babai i tij, Myrteza tregon se në një nga kampionatet e atletikës në Stamboll, meqë ekipi shqiptar nuk u paraqit, ambasada jonë atje e merr si përfaqësues nderi dhe Eltoni parakalon me Flamurin tonë Kombëtar me ekipet e vendeve pjesëmarrëse. Ishte atlet me ekipin e “Partizani”-it,

ku gjatë një kampionati është vlerësuar me vend nderi në Kore. Para emërimit (pas mbarimit të shkollës) ka marrë pjesë në lojërat olimprike të ushtrive në Itali.

## NË MISIONET PAQERUAJTËS NË AFGANISTAN, IRAK DHE KOSOVË

Në vitin 2005 shkon me togën e tij si komandant i Misionit të 5-të Paqeruajtës në Afganistan, ku i nderon me vizitën e tij ish-Presidenti Moisiu. Këtu, në Kabul, Eltoni është në krahun e majtë të kreut të shtetit shqiptar, si një nga komandantët më shembullorë të forcave tona paqeruajtëse.

## ELTON MYRKU, NË KRAHUN E MAJTË TË PRESIDENTIT MOISIU, NË KABUL

Në misionin e dytë shkon në Irak ku qëndron 9 muaj, por pa trupat tona, në përbërje të forcave amerikane, ku vlerësohet me Medaljen “Për merita luftime”.

Më 18 korrik 2008 shkon me kompaninë e tij në misionin e tretë në Afganistan.

Elton Myrku është oficeri i parë shqiptar që ka stërvitur trupat e NATO-s. Si i tillë, në vitin 2010 ai është pjesë përbërëse e kontigjentit tonë ushtarak dhe flamurbajtësi i Flamurit tonë kombëtar në ceremoninë e parakalimit në krye të flamujve të 27 vendeve, me rastin e pranimit të Shqipërisë në NATO. Tre herë, nga 6



(Vijon në faqen 16)

## ANALIZA

“Ideali i papërfunduar kombëtar”, përçon mesazhin e domosdoshmërisë të bashkimit të trojeve shqiptare

# HYSNI SHAQIRI FLET PA DROJË PËR BASHKIMIN E TROJEVE TONA

**SHPENDI TOPOLLAJ**

Në të gjithë krijimtarinë time publicistike kushtuar çështjes së pazgjidhur kombëtare dhe botuar si në shtypin e përditshëm ashtu dhe nëpër libra, ndër të tjera, kam shprehur përherë shqetësimin qytetar të heshtjes apo apatisë së pafalshme që po karakterizon intelektualët tanë. Prandaj, kur më bije në dorë ndonjë artikull analitik apo libri i kujtudo autori qoftë, rreth këtij problemi, jo vetëm që e lexoj me ëndje, por edhe ulem e shkruaj për të, gjë që më ka dhënë mundësinë që përveç shfaqjes së respektit e simpatisë, të shtoj edhe radhët e miqve të mirë. Kjo po ndodh mesa duket edhe me zotin Hysni Shaqiri, arsimtar, luftëtar dhe ish - deputet në Maqedoninë e Veriut, pas leximit të reflektimeve të tij politiko - atdhetare me titullin “Ideali i papërfunduar kombëtar”. Me fare pak fjalë paraqitet në fund të librit portreti i vetë Hysniut, por duke qenë se është i vërtetuar nga koha ai postulati se shkrimtarin do ta gjejmë brenda faqeve të librave të tij, më duket se e kam të plotë figurën e këtij intelektual, pra, karakterin burror, kulturën, dashurinë për Kombin tonë, dhe sidomos kurajën për t'i shprehur mendimet pa asnjë kompromis me këdo qoftë. Të këtij misionari që nuk ka rënë si shumë të tjerë në batakun e asaj që sociologu - filozof polak Zygmunt Bauman i cili nuk u pajtua me teoritë dhe praktikën komuniste, e quante dekadencën e intelektualëve. Në këto reflektime, ai ka vënë si nëntitull “Drejt Perëndimit, drejt inspirimit, drejt forcimit të shtetformimit” të cilat me domosdoshmërinë e përpjekjeve për bashkim, përmbajnë gjithçka trajton në këtë libër voluminoz prej njëzetetre kapitujsh.

Autori ka zgjedhur që në analizat e tij të heqë paralele midis historisë dhe politikës, midis të shkruarës dhe realitetit të sotëm, midis rezistencës trimërore të rilindasve tanë dhe komës ku kemi rënë, midis synimeve aneksioniste të fqinjëve dhe përpjekjeve të pareshtura për liri e pavarësi të shqiptarëve, midis hipokrizisë së politikanëve tanë dhe idealeve të pastra të popullit, midis kartës të të drejtave për vetvendosje dhe djallëzisë së diplomacisë ndërkombëtare që na kanë lënë të coptuar.

Hysni Shaqiri nuk mihon gjithçka është arritur, si fjala vjen shporrja e tiranisë serbe nga Kosova, pas luftës heroike të UÇK-së dhe forcave të NATO-s, dhe ato rezultate që u arritën të populli shqiptar në Maqedoninë e Veriut pas angazhimit në luftë të armatosur ndaj diskriminimit të dukshëm që u bëhej. Natyrisht që ishte Serbia ajo që luajti me shqiptarët në mënyrën më të pabesë dhe më kriminale. Ishte politika e saj aneksioniste, çkombtarizuese, shpopulluese, nënshtruese që çoi në doktrinën akademike deri në gjenocid të paparë, si ai i viteve 1998 - 1999. Hysni, kujton dëmet dhe padrejtësitë që na u bënë nga ato Kongreset e famshme, ku Fuqitë e Mëdha luajtën me kufijtë tanë si u desh qejfi, por nuk harron të theksojë se veçanërisht në vitet 1941 - 48, pra



periudha pas themelimit të PKSH nga emisarët jugosllavë dhe ndikimit të tyre si pasojë e nënshtrimit servil në emër të ideologjisë komuniste, sipas së cilës gjithçka do të rregullohej pas fitores së përbotëshme të saj.

Ja se si shkruan ky autor: “Vetëm duke parë dhe analizuar jo më shumë se tridhjetë vjet mbrapa nga viti 1912 nuk do të kishte asnjë arsye fare për të lidhur kontratë bashkëpunimi me komunistët serb gjatë Luftës së Dytë Botërore”. Për Hysniun edhe pas shpërbërjes së Jugosllavisë, ka një fakt substancial, ku trojet shqiptare në Maqedoninë e Veriut, në Luginën e Preshevës dhe në Mal të Zi nuk u çliruan nga pushtimi sllavo - ortodoks. Ai gjithashtu shprehet se edhe vartësia e Kosovës nga tekat e ndërkombëtarëve, qëndrimi i bindur i opozitës për lëshime Serbisë, apo ulja në bisedime me të, është një gabim i madh. Teoritë e lëshimeve, shkëmbimit të territoreve apo ato të “Ballkanit të Hapur, ku fitues dalin po serbët, janë krejt në kundërshtim me perspektivën e Kosovës. Për të dhe për çdo njeri me mend në kokë, është e pakuptimtë që veç të tjerave, të krijohen ato asociacio-

net serbe plot shejtanllëqe, brenda shtetit sovran kosovar. Ai përshëndet guximin e kryeministrit Albin Kurti dhe e thotë pa drojë, se ata udhëheqës që bëjnë politikën e gabuar të të huajve dhe po nxisin të rinjtë të braktisin vendlindjen, janë bataçqinjtë dhe maskarenjtë.

Mendimi i autorit të librit është se çelësi i suksesit si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri është politika e pavarur dhe me dinjitet, çka vjen së pari nga rritja e nivelit ekonomik të vendit dhe ruajtja e vlerave të trashëguara, pa të cilat “Atdheu ynë nuk do të ketë ditë të bardha”. Dhe ai shpreh keqardhjen e tij kur sheh se “mjerisht vazhdojnë të mbeten në pushtet po të njëjtët struktura që tërë kohën e kanë gënjyer shumicën si demagogë të sofistikuara”. Ata, për të garantuar karriget e tyre, urrejnë dhe përjashtojnë këdo që kritikon apo shfaq ide përparimtare. Për Hysniun, populli shqiptar i cili nuk është as afrikan dhe as aziatik, por evropian, duhet së pari të çlirohet nga armiku i brendshëm, e pastaj të mposhtë atë të jashtëm. Në çdo kapitull, ai nuk e fsheh bindjen se faktori kryesor i përparimit, mbetet përpjekja serioze për

bashkim e trojeve shqiptare, dhe heshtja për këtë çështje është tradhti kombëtare. Përplasjet mes veti që na kanë kushtuar aq shumë, duhet të marrin fund, se ato i shërbejnë akuzave serbomëdha, se ne shqiptarët, nuk kemi aftësi shtetformuese. Mjaft të rrezikshme e sheh ai edhe tezen se çështja jonë kombëtare do të zgjidhet në kuadër të proceseve integruese, pasi sipas tij, në BE pranohen shtete dhe jo populli i shpërndarë në shtete të tjera. Në kapitullin kushtuar bashkimit sipas të Drejtës Ndërkombëtare, autori kritikon ashpër edhe ata dritëshkurtër që duke u hequr si të “moderuar”, pajtohen me teorinë absurde të ndarjes së kombit në dy shtete. Në këtë drejtim punon edhe propaganda armiqësore që duke i quajtur shqiptarët popull pa vlerë, madje edhe ardhacakë, përhap idenë në Maqedoninë e Veriut fjala vjen, se në kushtet aktuale, merr përparësi fryma e bashkim - vllazërimit dhe nuk janë fare të nevojshme ndjenjat kombëtare. Parë kështu, ai këshillon domosdoshmërinë e zgjimit nga letargjia dhe kontributit të dy Akademive të Shkencave tona, apo edhe mbajtjen e një Kuvendi Mbarëkombëtar. Sipas tij, po nuk u zgjidhen këto probleme, nuk ka as marrëdhënie të mira me fqinjët dhe as paqe me ta. Edhe të huajt, kështu duhet ta shohin këtë, se ndryshe nuk do të ketë as stabilitet politik dhe as zhvillim ekonomik të qëndrueshëm si popull dhe komb shqiptar.

Më tej, Hysni trajton shoqërinë multietnike, ku ka parasysh Maqedoninë e Veriut, vend ku nuk ka barazi për të gjitha etnitë e sidomos për shqiptarët, duke i quajtura ata të huaj dhe që ai e përcakton si një gabim historik.

Vend, ku nuk mungon vullneti tinzar për të moszbatuar asnjë marrëveshje, duke filluar qysh nga ajo e Kuvendit të Parë në Manastrin Prohor Pçinski në 2 gusht të vitit 1944 e deri të Marrëveshjes e Ohrit. Libri merret deri edhe me nevojën e ndarjes së pushtetit nga krimi etj. etj. por ajo që duhet theksuar është thirrja që u bëhet veçanërisht intelektualëve që ta thonë pa drojë fjalën e tyre për ta ndërgjegjësuar si politikën, ashtu edhe masën e popullit se “Çdo popull që e harron të kaluarën e tij nuk mund të ketë një të ardhme të ndritur nëse nuk përkushtohet në korigjimin e padrejtësive nga e shkuara”.

Gjithmonë duke kujtuar se Hysni Shaqiri arrin në konkluzionin se “Athinën me atributet e shtetit në kohën e helezonizimit nuk e formoi demokracia, sepse ajo ekzistonte me fuqinë e saj, por persona publik si udhëheqës të saj me ide përparimtare në një moment kur Athina u përball me krizë ekonomike dhe politike pesë shekuj para Epokës së re”, pra njerëz të mençur si Soloni me shokë. Ai Soloni që nuk ia kishte dëgjuar këshillat mbreti i Sardes duke iu gëzuar pasurisë, dhe para stivës me dru, ku desh e dogji Krisua - tregon Sami Frashëri - thirri: Solon! Solon! Solon! Prandaj, ky libër është dhe një apel që t'i dëgjojmë të mençurit tanë sa nuk është vonë, se nuk do ketë më mbret të na falë.

47 VJET MË PARË

# Kur kremtohej 100 vjetori i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit

- **Me 8 qershor 1878, Abdyl Frashri, Iljaz Pash Dibra, Sheh Mustafa Tetova, Ali Bej Guçia, Ahmet Bej Koronica lanë Stambollin e u nisën me tren për Kosovë. Në Selanik u bashkuan me delegatët e Janinës dhe në mbrëmjen e 9 qershorit arritën në Prizren. Të nesërmen më 10 qershor 1878 u shpall formimi i një organizate politike që mori emrin "Lidhja e Prizrenit"**

**Beqir Shehu,**

**Studjes në fushën e Historisë**

Në gjysmën e dytë të shekullit 19-të, shtetet e Evropës e në veçanti ato të Ballkanit, për realizimin e bashkimit kombëtar të tyre, u mpleksën në vorbullën e ngjarjeve më aktive të kohës, që njihet në histori me emrin "Krizë Lindore".

Ndërhyrja e fuqive të mëdha për të realizuar interesat e politikës së tyre dhe, duke nxitur oreksin shovinist të mbretërve të shteteve fqinjë; të Serbisë, Malit të Zi, Bullgarisë e Greqisë, për të zgjeruar kufijtë e shteteve të tyre në kurriz të tokave shqiptare, e vunë Shqipërinë në rrugën e asgjësimit të saj si komb dhe territor. Kjo nga njëra anë dhe nga ana tjetër, rreziku i shembjes së gërmadhës feudale-ushtarake turke, kalbëzimi i së cilës u duk sheshit në luftën ruso-turke të vitit 1877, kërkonte shpëtimin një orë e më parë të Shqipërisë si një vend i lirë e autonom, për të shpëtuar rrezikun të rënjes viktime nën muret e saj.

Acarimi i mëtejshëm i Krizës Lindore, si rezultat i shpërthimit të luftës Ruso-Turke të vitit 1877 dhe traktati i paqes së Shën Stefanit, treguan se Perandoria Turke nuk ishte e aftë të ruante statukuenë në kuadrin e saj.

Krijimi i Provincës Bullgare që Rusia i imponoi Konferencës së Stambollit në janar të vitit 1877 prekte krahina të gjëra me popullsi shqiptare që arrinin deri në lumin Drin, duke cënuar kështu edhe një pjesë të mirë të tokave të Sanxhakut të Dibrës si Rekën, Dibrën e Epër, Gollobordën e deri tek ua e Çerenecit.\* (Xhafer Belegu, Lidhja e Prizrenit, Faqe 172--173).

Kjo indinjoji pa masë popullin e Dibrës. Me vendosmëri e besim të patundur në forcat e veta, ata deklaruan se: "Më mirë të shuhemi deri në burrin e fundit se sa të hymë nën kuadrin e Bullgarisë, kundër të drejtave të kombit shqiptar". (Xhafer Belegu, e cituar).

Këtë mënyrë proteste për padrejtësitë e Traktatit të Shën-Stefanit, e shikojmë edhe në telegramin derguar nga Prizreni, konsullit të Francës në Selanik me 3 qershor 1878, nënshkruar edhe nga përfaqësuesit e Dibrës, ku veç të tjerave thuhet: "Duke u ndodhur përpara këtyre përmbysjeve tokësore, padrejtësisë e të cilave është e dukëshme, neve përfaqësues të banorve të të gjithë rretheve të vendit, duke qenë të mbledhur në Prizren, jemi të vendosur të mos lëshojmë asnjë pëllëmbë nga tokat shqiptare" (Arkivi institutit hist, fondi Francez).

Kongresi i Berlinit që u mbledh për të rishikuar traktatin e Shën-Stefanit në fafor të fuqive të mëdha perendimore, jo vetëm e mohoi qenien e kombit shqiptar e çeshtjen kombëtare shqiptare, por



**Nga Sesionin shkencor në Prishtinë, në 100-vjetorin e Lidhjes së Prizrenit-Nga e majta në të djathtë: Prof. Stefanaq Pollo, Drita Mehmeti, Prof. Bujar Hoxha, Shyqyri Ballvora, Prof. Zia Xholi, Thoma Murzaku, Beqir Shehu – Prishtinë, 8 qershor 1978**

edhe vendosi coptimin e pjesve të truallit amtar në favor të shteteve fqinjë.

Të gjitha këto krijuan në Shqipëri bindjen se tani ishte fjala për jetën a vdekjen e kombit shqiptar, për qenjen apo zhdukjen e tij nga harta e Ballkanit. Nga kjo bindje shpërthyen manifestime e protesta të fuqishme nga të katër anët e vendit dhe u realizue në mënyrë spontane mobilizimi popullor për vetëmbrojtje. Kjo gjendje kërkonte të krijohet një forum drejtues që të përfaqësonte të gjithë kombin për të zhvilluar veprimtarinë e nevojshme politike brenda e jashtë vendit, detyrë të cilën e kreu "Komiteti Qendror për mbrojtjen e të drejtave të kombësisë shqiptare" që u formua në Stamboll më 1877 dhe ku morën pjesë mendjet më të ndritura të kombit shqiptar.

Me 8 qershor 1878, Abdyl Frashri, Iljaz Pash Dibra, Sheh Mustafa Tetova, Ali Bej Guçia, Ahmet Bej Koronica lanë Stambollin e u nisën me tren për Kosovë. Në Selanik u bashkuan me delegatët e Janinës dhe në mbrëmjen e 9 qershorit arritën në Prizren. Të nesërmen më 10 qershor 1878 u shpall formimi i një organizate politike që mori emrin "Lidhja e Prizrenit. Kryetar i Këshillit Qendror u zgjodh Iljaz Pash Dibra. Iljaz Pash Dibra u zgjedh edhe kryetar i Kuvendit.\* (Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, 1878\_1912, f.47,57., Haki Stermilli, Dibra në prag të Historisë, dorshkrim, Tiranë 1940, f.47).

Konsulli austriak në Shkodër Lipih, në një raport që i dërgonte Vjenës më

22 qershor 1878, shkruante se punimet e Kuvendit i drejtoi delegati më i moshuar Iljaz Pash Dibra.\* (Historia e Shqipërisë, Vëll. II, 1965, f.129).

Në zgjedhjen e Iljaz Pash Dibrës, si kryetar i Kuvendit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, afërmendësh që ndikoi statura e tij politike. Ai ishte një veteran i luftimeve të armatosura që zhvilluan shqiptarët, e veçanërishtë dibranët, kundër tendencave tanzimatiste të Stambollit dhe kundër synimeve grabiqare të fqinjëve. Me autoritetin dhe prestigjin që gëzonte, punoi energjikisht pa marrëparasyshë moshën, për bashkimin e viseve shqiptare rreth programit kombëtar të Lidhjes Prizrenit në Kuvendin e Dibrës më 20 korrik 1878 dhe më 10 nëntor, 1880.

Zgjidhja e detyrës së dyfishtë që situata i diktoi Lidhjes edhe në degën e Dibrës (që disa kohë qe edhe rezidenca e saj)\* grishi në arenën e luftës një grupim të fuqishëm, mjaftë aktiv të forcave lëvizëse, sidomos të masave popullore që shënuan momente të rëndësishme ngjitjeje, duke dhënë një kontribut të vlefshëm në historinë e luftës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në të gjitha etapat e zhvillimit të saj. Përfaqësuesit e saj aktiv si Iljaz Pash Dibra vlezërit. Ahmet e Isuf Karahasani, Isuf Doda, Xhemal Pash Dibra, Bajram Buci, Llan Kaloshi, Hoxhë Moglica, Mustafa Lita, Shaqir Palushi,, Hajredin Pitarka, Sahit Daci Halil Cami, Mustafa Shehu e dhjetra të tjerë, duke përfaqësuar klasa e shtresa të ndryshme dhe duke qenë nën ndikim-

in e plotë të ndjenjave dhe veprimtarisë patriotike, ata ngritën Degën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Dibër, duke vepruar me zgjuarsiri që në fillim e qëndruan me trimëri deri në fund.

Me organizimin shoqërorë dhe me traditat patriotike që kishte, Dibra dispononte ato forca ekonomike, ushtarke e politike, të lira e të pavarura që nuk mundet të mos tërhiqte vemendjen e politikanit trim e mëndjendritur, organizatorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Abdyl Frashri, që shikonte te Dibra një prapavijë të sigurtë dhe një forcë goditëse të fuqishme në realizimin e detyrave të Lidhjes.

Edhe pasi Kongresi i Berlinit i cili anulloi vendimet e Traktatit të Shën Stefanit, dhe territorit të Dibrës iu largua rreziku i coptimit, Dega e Lidhjes në Dibër, me po atë veprimtari e guxim i drejtohet ambasadorit të Francës në Stamboll: "Kongresi i Berlinit e gjykoj me vend të bëj një veprim të padrejtë duke i dhënë Serbisë e Malit të Zi disa lokalitete pjesë të Shqipërisë, ndër të tjera Plavën e Guçinë. Shqiptarët kanë rrokur armët dhe janë të vendosur të mos lëshojnë as një pëllëmbë nga tokat e tyre...."

Ata janë të gatshëm të sulmojnë Malin e Zi dhe Serbinë për të marrë lokalitetet që na i morën në befasi. Në rastëse lutjet tona të drejta nuk do të merren parasyshë, deklarojmë se të gjitha fatkeqësitë që mund të ndodhin

(Vazhdon në faqen 11)

83-VJETORI

# Në festën e Çetës së Gorë-Oparit

*Duke përkujtuar dhe nderuar ngjarjet e spikatura, luftëtarët dhe dëshmorët, iu përcjellim brezave një mesazh të qartë shembulli dhe krenarie për sakrificat dhe arritjet e Ushtrisë Partizane, por edhe mësimin, që nëse e kërkon prap situata, populli patriot do ta përsërisë sa herë të ketë nevojë Atdheu...*

(Vijon nga fq.3)

**Ing.Maksim VINÇANI**  
**Nënkryetar i OBVL**

**K**jo çetë, me rreth 20 luftëtarët e parë, pati si bërthamë njësitin e armatosur të formuar rreth 3 javë më parë, më 27 maj 1942. Po ashtu, në vazhdim, ishte në përbërje të Batalionit "Ali Kelmendi" (formuar në qershor 1943), e më pas në Brigadën e IVs (formuar në nëntor 1943). Gjithashtu në këto kohë kujtojmë dhe 82 vjetorin e çlirimit të gjithë krahinës...

Mbas vendosjes së kurorave në lapidarin kushtuar formimit të çetës dhe dëshmorëve, Administratori i Njësisë Administrative Gorë-Moglicë Z. Nazmi Qose përshëndeti banorët e pranishëm dhe të ftuarit duke ju uruar mirseardhjen.



Fjalën e rastit e mbajti Kryetari i Bashkisë Maliq Z. Gëzim Topçiu...

Me të drejtë shoqëria kujton dhe përulet me respekt përpara dëshmorëve që dhanë jetën, ndaj luftëtarëve që sakrifkuan si dhe komandantëve të tyre.

Por jo më pak merita ka populli i thjeshtë, i cili dha një kontribut të jashtëzakonshëm për mbështetjen e forcave partizane, duke i furnizuar ato me ushqime, veshmbathje, strehim.

Dhe këto nuk janë "fjalë të bukura", por një realitet, sepse me varfërinë që mbizotëronte, në fakt ato shtëpi ndanë me partizanët kafshatën e familjes, rrezikuan, bile shpesh disa e paguan me grabitje e me djegie shtëpie, me internime deri dhe me vrasje të anëtareve të familjes nga okupatori, dhe pa ato ndihma nuk do të kishte pasur Ushtri Partizane.

Historia e Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri duhet të na bëjë krenarë

për faktin se populli patriot shqiptar tregoi që kur është fjala për lirinë e vendit, është në gjendje të bëjë heroizëm.


Duke përkujtuar dhe nderuar ngjarjet e spikatura, luftëtarët dhe dëshmorët, iu përcjellim brezave një mesazh të qartë shembulli dhe krenarie për sakrificat dhe arritjet e Ushtrisë Partizane, por edhe mësimin, që nëse e kërkon prap situata, populli patriot do ta përsërisë sa herë të ketë nevojë Atdheu.

Gjithësesi, asnjëherë si instrument në shërbim të instalimit të ndonjë ideologjie, apo për objektiva politike, por vetëm për mbrojtjen e vendit nga pushtues të huaj...

**Lavdi Dëshmorëve dhe  
Luftëtarëve të Krahinës së Gorës e  
të gjithë Qarkut të Korçës!  
Lavdi Ushtrisë Partizane  
Nacionalçlirimtare!  
Lavdi popullit Shqiptar!**

## Kur kremtohej 100 vjetori i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit

(Vazhdon në faqen 11)



do të bien mbi të gjitha qeveritë Europjane". (Nënshkruar, Kryetari i Lidhjes, Meriman Eliaz) (Arkivi i Institutit të Historisë, "Fondi Francez").

Pjesmarrja e malsorve dibranë në ushtrinë e Lidhjes, me eksperiencën e tyre të vyer luftarake si dhe me guximin dhe trimëritë e njohura jo vetëm brenda caqeve kombetare ndikuan në fitoret e rëndësishme që u korrën si kundër forcave malazeze në Plavë e Guci ashtu edhe kundër atyre turke në një serë betejash. Këto vargje të kësaj kënge popullore tregojnë se sa lartë ua ngjinte moralin luftëtarëve në betejë, pjesmarrja e malësorve Dibranë.

"Ni takam që janë gjakovas, Bajnë vrisht e hidhen n' topa. Hidhen n' topa

hidhen n' gryka, Bajnë shyqir se na erdh Dibra".

Një veprimtari e mençur e trimërore e Kryetarit të Lidhjes së Prizrenit Iljaz Pash Dibra, në mbështetje dhe fuqizimin e Lidhjes, me të gjitha krahinat e Shqipërisë, ishte thirrja e dibranëve në Kuvendin e madh historik që u mbajt në Qeranicë të Dibrës së Epër në korrik të vitit 1878, në praninë dhe të Abdyl Frashrit. Thirrjes së kryetarit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ju përgjigjën 10000 burra nga Dibra e Epër dhe e Poshtëme. Tri ish-in çeshtjet që udhëheqësit e këti Tubimi, Iljaz Pash Dibra e Abdyl Bej Frashri, kërkuar nga dibranët: Solidaritet me vendimet e Kuvendit të Prizrenit, gadishmëri për të mbrojtur Trojet Shqiptare nën udhëheqjen e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, dhe të hiqet dorë nga gjakmarrja. Nëse për dy të parat dibranët u treguan të gatshëm, për të tretën vunë si kusht Besën, që të zgjaste derisa kohë të qëndronte dhe rreziku i coptimit të trojeve shqiptare. Në tubim foli Abdyl Frashri:

"Sot është e nevojshme ti falim gjaqet, sot që armiku kërkon të pi gjakun tonë, duhet me deomos të luftojmë për lirinë dhe jo kundër njëri tjetrit. Me ti thënë këto fjalë, të 10000 i lëshuan armët përtokë, aq sa shugulluan edhe malet, dhe si të dilte nga një gojë e vetme u dëgjua një britmë:

Falma gjakun e për këtë besë!

Gjaku falë e besa besë!" (LaNazi-one Albanese, 31 gusht, 1889, nr. 6, f.56. Kristo Frashri, Lidhja Shqiptare e Prizrenit, 1878—1881, f.258-259).

Falja e gjaqeve e lidhja e Beses në Dibër, pati rëndësi të veçantë sepse mbi këto u arrit të ngrihet një ushtri vullnetare me mbi tre mijë vetë të cilët u vunë në dispozicion të Lidhjes Shqiptare të

Prizrenit. Konsulli britanik në Selanik B Barkes në një raport që i dërgonte qeverisë së tij më 22 shtator 1877, informonte se:

"Selim beu (Rrusi), është angazhuar për të përgatitur trupën prej 4000 vetash të ushtrisë jo të rregullt vullnetare shiptare për të qenë kufitare. Propozimi i tij është pranuar dhe këta njerëz janë ndarë në tre çeta, 1500, 1300 dhe 1200, duke marrur tre drejtime të ndryshme.... Këta shqiptar (gegë) janë rraca më e rrept e shqiptarve."\* (Skënder Rizaj, Synimet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në dokumentet angleze. Prishtinë 1978, f. 47".

Dibra u bë edhe epiqendra e kërkesave dhe e luftës për autonomi. Për këtë qëllim më 20 tetor 1880, pikërisht në Dibër ku ndërkohë kishte kaluar edhe qendra e Lidhjes, u mbledhën në kuvend përfaqësuesit e Krahinave të Shqipërisë. Në rezolutën e tyre drejtuar Portës së Lartë, ata përsëritën me një forcë të re kërkesat konkrete të xhveshura tashmë nga lajkat diplomatike, të cilat morën formën e vendimeve të prera:

1. Të gjithë viset shqiptare të katër vilajeteve të përmbledhen në një vilajet të vetëm dhe të caktohet si qendër një qytet i cili të ketë lidhje në çdo anë të saj.
2. Të gjithë nëpunësit që do të jenë në shqiperi duhet të dinë gjuhën e vendit.
3. Të përhapet arsimit dhe në shkollë të mësohet edhe gjuha shqipe.
4. Të zbatohen vendimet që do të merren për reformat e dobishme për shtetin dhe kombin nga ana e kuvendit të përgjithshëm i cili do të mbledhet në 4 muaj çdo vit në qendrën e vilajetit.
5. Të ndahet një sasi e mjaftueshme nga të ardhurat e përgjithëshme të vilajetit për përparimin e arsimit si dhe për ndërtime publike \* (Akte të Rilindjes Kombëtare Shqip-

tare, 1878—1912, f.47, 65, 66).

Fazën më të lartë të luftës ndaj Portës, Lidhja e Kurorëzoi me formimin e Qeverisë së përkohëshme në janar të vitit 1881, qëndrimi konsekuent edhe i udhëheqësve të degës së Lidhjes në Dibër, i mbështetur në patriotizmin luftarak të masave popullore që ushqenin një urreitje të madhe ndaj administratës turke bëri që ata të përzanë myteserifin bashkë me qeveritarët turq, duke ushtruar veprimtarinë e vet me plot autoritet më qëllim për tu bërë autonom.

Kontributin e Dibrës e shikojmë edhe në luftën që zhvilloi për mbrojtjen e Lidhjes kundër forcave turke të Dervish Pashës Dibranët morën pjesë në të gjitha betejat kundër Dervish Pashës që në Shtimje, Slivovë, Dule, Suharekë, Kala e Dodës e deri në atë të Dohashishtit, ku gjaku i bijve të Dibrës së bashku me gjakun e të gjithë shqiptarëve shkruan atë thirrje luftarake të cilën e dëgjoi e gjithë bota se Shqipëria është një komb etnik, me gjuhë e truall të vetin, që asgjë nuk e lidh me anadollin e as me ndonjë vend tjetër.

Të gjitha këto provojnë se Dega e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Dibër, si një organizatë politike që i kishte rrënjët në popull diti të udhëheq dibranët me elasticitet e dinamizëm, si në luftën diplomatike ashtu edhe me armë, për mbrojtjen e trojeve shqiptare. Duke u bazuar në materialin faktik që paraqitëm themi me plotë gojën se Lidhja Shqiptare e Prizrenit ishte veper e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare për të cilën kontriboi Kosova, Dibra, Shkodra, Pollogu, Luma, e pothuaj e gjithë Shqipëria u vu në pulsion patriotik të kohës për një Shqipëri të bashkuar ku të përfshiheshin katër vilajetet shqiptare përfshi Shkupin e Janinën.

## KULTURË

Një shikim për artin e atdhetarit të madh, shqiptarit nga Maqedonia që jeton në Zvicër

# Pikturat e Vesel Xhaferrit, “opus” me mesazh të qartë njerëzor

• Në vitin 2015 Veselit hapi ekspozitën personale të në Muzeun Historik Kombëtar, nën kujdesin personal të të ndjerit Moikom Zeqo...

**Fatmir Minguli**


Veseli Çeliku është i lindur në fshatin Cërvice – Kërçovë, në 1955. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje dhe pastaj emigroi në Zvicër dhe atje shpejt integrohet në jetën arsimore të shtetit Helvetik. Veseli kryen Akademinë e arteve nën udhëheqjen e artistit të madh Didian Freks në Mulhauzen. Pastaj punoi si artist në “Cirkus Freks Variate” dhe mbaroi degën e “Fakirëve” në vitin 1973 - 1975. Në vitin 1997, Veseli hap ekspozitën e parë personale në Lucern-Zvicër. Ai merr pjesë në Ekspozita kolektive në Gjenevë me shumë krijues të vendeve të ndryshme. Gjithashtu Xhaferrit ka marrë pjesë në ekspozita të organizuara në Tiranë, Kulmak Baba Tomorri, Shkup, Strugë dhe në Kërçovë.

Por të pashlyera nga mendja do të jenë aspektet e hapjes së ekspozitës personale të Veselit në Muzeun Historik Kombëtar nën kujdesin personal të të ndjerit Moikom Zeqo në vitin 2015. Përpos teknikave të zakonshme, piktori Vesel Xhaferrit përdor gjërësisht pikturimin pikësor. Që në pamjet e jashtme të jep idenë e një mozaiku por që nuk është mozaik. Ai më shumë i përafrohet disa vizatimeve që janë në librin “Manuskript i Vojniçit” për më tepër nga mënyra, teknika dhe kompozimi i disa pikturave. Kjo nuk është e vertëtuat plotësisht por që mbetet një tentativë interesante e pandeshur në piktore të tjerë.

Nga ana tjetër duke parë me qetësi pikturimet e Vesel Celikut sheh se teknikat e pikturimit pikësor janë si tendencë e tij për të ndërhyrë në format dhe pamjet e qendismave popullore të Kërçovës e për më shumë për të vënë në dukje jetën e komunitetit të vet.

**VLERËSIMI NGA Dr.NUHI VINCA**

Me të drejtë dr. Nuhi Vinca ka për-



caktuar se pikturat e Vesel Xhaferrit, janë një “opus që përcillet me mesazh të qartë njerëzor, me dashuri për figurat historike me një krijimtari plot dinjitet, të djeshme dhe të sotme...” Ai sjell Skënderbeun, bektashiun e madh, Naim Frashërin, poetin dhe teoricienin mbi bektashizmin, Mic Sokolin, Imam Hysenin, nga të parët e bektashinjve dhe Haxhi Bektash Velion, etj. Ai ka guxim, dashuri, njohje dhe re-

spektim të popullit shqiptar, ka art dhe eksperiencë që arrin këto përfaqësime të një pjese të botës shqiptare në jetën e përditshme ku intesektohet besimi i veçantë ndaj bektashizmit.

Ndoshta ky faktor i besimit ndaj bektashizmit e ka çuar këtë artist poliedrik në zhvillim të vazhdueshëm e jo vetëm me piktura me pikëzime. Një magji e çuditshme feks në veprat e tij të pikturës çka dallohet edhe në poezitë e tij po aq të ndjera shpirtërisht. Por, magjia e vërtetë e shpirtit krijues qëbdron në embrionin e madh të dashurisë për njerëzit. Veprat e mia -thotë ai kanë magjinë e lëmis së mesazheve për rininë e sotme dhe të ardhme për t'u bërë sado pak një zëdhënës që me ndihmën e zotit të jem i dobishëm në këtë botë që jetoj.

**SI MË RA NË DORË LIBRI I FATMIR MINGULIT “KUNDRA IKONATHYESVE?”**

Isha në lixha t Elbasanit në Tregan, kur më vjen një mesazh nga Poeti Shkrimtari kritik gazetar z. Minguli – {Veseli ka dalë libri jem. Një vështrim mbi filozofinë e bektashizmit Shqipëtar.”

Dhe asht interesant sepse kam kënaqësinë që doli nga shtypi ku shkruhet se Misionarët e parë bektashian u dërguan në Shqipëri dhe në vendet tjera të Ballkanit nga qendra e madhe Bektashiane e Dhimotekës në Bullgari... Këta misionarë shkuan në Shqipëri e asaj kohe gjatë shekujve XII-XV - të ku sipas të dhënave edhe të Baba Ejupit që kishte marrë lidhjet edhe ardhja e Hider Babajt në Brod me Dikmen Baban e Kanatllarit, por unë do të ndalem në këtë që kemi përpara për Teqenë “ Turballi Sulltan dhe historinë e saj shkruajnë shumë saktë stjudjusit Kujtim Boriqi dhe Syrja Xhelaj në librin e tyre “ Baba Shefqet Gllava Martir i demokracisë “: E ndërtaura në vitin 1490 në zonën e

Menit midis Farsallës dhe lidhur kjo teqe, me shumë ngjarje të kohës por mos të largohem nga e para z. Fatmir Minguli më tha se gjithë libri ka të dhëna posaçërisht për Bektashinjët. Por në thellësi të librit në faqen 163/164/165, ku autori tashmë i ndjer Moikom Zeqo hedh dritë mbi Bektashizmin e Skënderbeut në shekullin e XV - ka një fakt të jashtëzakonshëm që quditrisht nuk përmendet në Historinë zyrtare të Gjergj Kastriot Skënderbeu, ka dëshmi të sakta se Skënderbeu gjatë kohës që ishte në trupat e Jeniqere në pallatin e sulltanit u konvertua në Bektashian sëbashku me nipin e tij Hamzan. Ku Myrshidin i tija ishte Baba Ali - AL-Ula, dhe me urdhër të Sulltanit aji u arrestua ku sulltani i kërkoi që të këthehet Skënderbeu por Babai refuzoi nuk mund të thyejë besën e dhënë që të këthehet një burrë shteti... aji ka krye shtetin e vet ashtë interesant sepse nuk janë të dhënat se qysh u bo me Babanë Ali - AL-Ula dhe thuhet se ashtë djegur i gjallë në Teqenë e Stambollit. Kështu që unë rashë dakord me z. Fatmir Minguli dhe ti marr librat në Kërçovë sepse biblioteka e Teqes ka nevojë për libra dhe me një Kontakt me z. Naim Ibraimi në Amerikë dhe i tregova rastin ku aji mu përgjigj as një as dy xhaka Veseli sa duhet vetëm trego se unë do të jesh sponsor i këtij libri dhe më pyti a mund ti bashkohen edhe disa bashkëndas ku unë e falënderova dhe i thashë se ashtë kënaqsi për atë që thoni dhe kështu ju bashkua edhe z. Nexhat Mustafa nga Ne York kurse Naimi Ibrahim kishte të atin në rrugë xhaka Imer Ibrahim dhe aji më thoshte - “Veseli Naimin e kam larg por le të jetë mirë atje në Amerikë por edhe një rastë ku aji kishte punuar në minjerën e Tajmishtit me dajën tem Zeqir Sadiku thoshte e ndanjëm kafshatën e bukës dhe të dy tashmë të ndjer, por edhe njëher një falënderim për juve nga Amerika”.

**Mevlud BUCI**

Njerëzit e mirësisë dhe zotësia ngjanë me mineralin. Ata kanë prova pune dhe drejtësie, si Rufat Bruçi, nip i Lam Tahir Bruçit dhe mik i Totrakut. Ai ka drejtuar në Lukan për shumë vite si brigadier, si burrë i urtë i dijes dhe i fjalëve, duke marrë respektin dhe mirënjohjen e shumë njerëzve.

Në Lukan u lind dhe u rrit Faik Dan Bruçi - veteran i hidrocentraleve dhe ndërtaues. Këtu ka akoma kullën e tij luftëtari i lirisë Mahmut Shaban Bruçi, Zeqir Ndreka, Bajram Bruçi, Destan Isuf Buci, Haxhi Lami (Totraku), Bajram Loshaj, Shaqir Bruçi, Halit Dervish Bruçi (inxhinier), Hysen Mehmet Dervishi, Hysni Hasan Bruçi, Jonuz Ibrahim e Bajram Lleshi etj.

Nga Lukan është edhe Nuredin Dervishi, Haxhi Dervishi, Abaz Pepa, Haxhi Lami, Destan Buci e Ai Totraku.

Rufat Bajram Bruçi sot mbi 75 vjeç ende jeton i fortë e krenar, sepse veç vilës në Kinostudio, ka mbajtur edhe kullën e gurtë në Katin e Shtatë të Lukanit rrëzë Runjës. Sot në Laç -Va Deja, jeton e punon biri i veteranit Haxhi Totraku, Kujtim Totraku. Anë e mban atdheut

*Thirrja e vendlindjes vjen së brendshmi në mënyrë të heshtur, si amaneti i të parëve që ajo të mos braktiset*

## Veteranë të luftës e të punës nga Lukan rrëzë Runjës

• *Rufat Bruçi i dha nderim kullës së tij në Lukan dhe kulla i jep nderim si ndërlidhje dhe vazhdimësi traditash...Koha, jeta dhe brezat i vlerësojnë ata që lanë gjurmë diturie, pune e mirësie, gjurmë qëndrese, si: Llan Destan Ndreka, Avdi e Shaban Dervishi, Sali Totraku, Hoxhë Buci - veteranë të diturisë, si dhe studiuesi i talentuar Bajram Xhemal Totraku e plot të tjerë.*

janë veteranët e Lukanit, si Mjeshtri i Madh Besim Ndreka, Xhetan Ndreka, Hazis e Ferit Ndreka. Ata krenarojnë jo vetëm veten, por edhe komunitetin e Lukanit, kudo që ai ndodhet.

Rufat Bruçi i dha nderim kullës së tij në Lukan dhe kulla i jep nderim si ndërlidhje dhe vazhdimësi traditash, kujtesa e të cilave dhe ushtrimi i tyre merr vlerë në kohën e re.


Koha, jeta dhe brezat i vlerësojnë ata që lanë gjurmë diturie, pune e mirësie, gjurmë qëndrese, si: Llan Destan Ndreka, Avdi e Shaban Dervishi, Sali Totraku, Hoxhë Buci - veteranë të diturisë, si dhe studiuesi i talentuar Bajram Xhemal Totraku e plot të tjerë, t e cilët e kanë kaluar jetën këtu, por edhe nëpër atd-

he, duke dhënë shembullin e dibranit punëdashës dhe dijedashës.

Rufat Bruçi ky gen malësori që njeh e respekton traditat, është një veteran i punës, i cili kudo që punoi nuk e kurseu veten dhe as mundin e tij, duke qenë fjalë mirë e punëdashës dhe duke respektuar këdo që punon vetëm me ndershmeri.

Edhe pse mbi të 75-tat, ai nuk e harron kullën e tij, këtë karakoll qëndrese ku vigjëluan dhe luftuan paraardhësit e tij. Thirrja e vendlindjes vjen së brendshmi në mënyrë të heshtur, si amaneti i të parëve që ajo të mos braktiset.

Edhe kushërinjtë e tij: Faik Dan Bruçi, Haliti, Ruzhdiu (djemtë e Isuf Bruçit të Totrakut) kanë bërë gjithçka



për truallin e tyre dhe për vendlindjen, jo vetëm si një sadsifaksion shpirtëror, por edhe si detyrim ndaj saj; ndaj porosisë së të parëve, që vendlindja të mos harrohet...Midis këtyre emrave të nderuar spikat dhe merr vlerën e tij edhe veterani Rufat Bruçi.

**LIBRI 29-TË**

“Më 17 korrik 2025, ora 18.00, promovimi në Akademin e Shkencave nga OBVLP dhe “Univers”

# PËRJETËSIMI I TË VIRTYTSHMIT MEHDI LUCA NGA HALIL RAMA

**Prof.dr. Petrit BARA**

**Mjeshtër i Madh&Zv/Rektor i  
Universitetit “LUARASI**

Në këto kohë të globalizimit, përballë agresionit të mediave të shumta sociale, botimi i një libri monografik të shkruar është ngjarje e rëndësishme. Sepse siç thonë latinët “e shkruara mbetet”.

Kësaj sentence të përbotshme i është përmbajtur besnikërisht shkrimtari dibran Halil Rama – Mjeshtër i Madh dhe “Qytetar Nderi” i bashkisë Bulqizë, duke shkruar, botuar, promovuar dhe duke futur

• *Nëpërmjet kësaj monografie lexuesi njihet me aktivitetin luftarak të Mehdi Lucës gjatë Luftës së lavdishme Antifashiste Nacionalçlirimtare, me kuadrin e devotshëm të shkolluar në të famshmin Internat i Kastriotit, me njeriun që sa qe gjallë vështrimin e kishte nga vendlindja...*

Nderi”, vetëm një muaj pasi ky titull ju dha edhe nobelistit Ferid Murad, ndërkohë që Universiteti i Tetovës më vlersoi me titullin doktor “Ho-

miqtë e familjes së tij, si dhe solidaritetin vëllazëror e miqësor.

Ndërsa përsa i përket personazhit kryesor të librit, Mehdi

**HALIL RAMA**

**MEHDI ISLAM LUCA**  
SHEMBULLI I NJERIUT DHE NJERIU SHEMBULL

“Libri monografik, ‘MEHDI ISLAM LUCA – SHEMBULLI I NJERIUT DHE NJERIU SHEMBULL’, i shkruar me një përkushtim dhe dashuri prej humlimesi, dokumentuesi, analisti, nga pena e mirënjohur dhe kreative e Halil Ramës – autor i 29 librave dhe 10 skenarëve të dokumentarëve televizivë, është një vepër e një rëndësie, gjithësi të veçantë, së pari për përjetësimin e të virtytshmit Mehdi Luca, së dyti për komunitetin që Ai i përket, së treti për brezat e ardhshëm dhe së katërti për historinë dhe krijimin e një tradite të shkrimit të dokumentuar, traditë kjo, e cila i ka munguar dhe vazhdon t’i mungojë kulturës shqiptare...”

**Prof.dr. Petrit BARA**

**PËR MEHDI LUCËN DHE DARDHËN E DIBRËS**

“Nivrosja e Halil Ramës në fushën e monografive letrare, ku numëron dhjetë të tilla, (pesë për Dardhën dhe personalitetet e saj), ka bërë që edhe kjo monografi për Mehdi Lucën të rrjedhë lirisht sikurse monografië e mëparshme, ajo për Muharrem Xhedikun, Skënder Calën, Bajram Ndreun, Isuf Rashën etj., por pa përsëritur njëra tjetër...”

**Sakip CAMI**  
Poet dhe studios

Çmimi 1000 lekë



**MEHDIU YNË...**

“Respekti nuk kërkohet. Respekti fitohet. Mehdi Luca e pati fituar respektin. Me punë e me sjellje....”

... Mehdi Luca është i gjallë për të gjithë ne. Me të gjitha të mirat që pati. Dhe s’ka më mirë, kur njeriu që iken, është përsëri i gjallë...”

**Prof. Dr. HAJRI SHEHU**

në fondin e letërsisë dokumentare shqiptare dhjetra monografi letrare.

Që në fillim dua ta falenderoj këtë autor mjaftë produktiv e cilësor, për monografi të që ka shkruar e botuar për disa personalitete të Dardhës, si për kompozitorin e tangos shqiptare Muharrem Xhediku, për ikonën e artit e kulturës kombëtare Skënder Cala, për Bajram e Lutfi Ndreun, për Isuf Rashën si dhe për shkrimet brilante në librin e tij të fundit “Dibra dhe dibranët në panteonin e vlerave” dhe shtypin qëndror – biografi të letrarizuar kushtuar Nderit të Kombit Hazis Ndreu, i njohur si “Ezopi i Dibrës”, për Liri Rashën që e ka pagëzuar si “pasaporta artistike” e Dibrës, për zërin e lavdisë shekullore Qerim Sula, për Mjeshterin e Madh Muharrem Gjoka – Qytetar Nderi i Qarkut Dibër dhe Presidenti i Ansambllit Artistik “Hazis Ndreu”, etj, etj.

Personalisht kam provuar emocionet e botimit të disa artikujve të Z. Halil Rama, si përcjellje e profilit tim njerëzor intelektual e profesional dhe të veprimtarive të mia publike, jo vetëm në Tiranë, por edhe në Peshkopi, Bulqizë Dibër të Madhe, Kukës e Tetovë ku më kanë vlerësuar me titullin “Qytetar Nderi”, (në Tetovë jam, vlerësuar “Qytetar

noris Causa”), si dhe kur më është dhënë titulli “Mjeshtër i Madh” nga Presidenti i Republikës.

Gjithsesi, me librin e tij të 29-të, ka meritën e përjetësimin të Mehdi Lucës, një personaliteti i Dardhës dhe i gjithë Dibrës që me veprimtarinë e tij jetësore mbi të gjitha fitoi titullin NJERI.

Duket fare qartë kjo që në titullin sinjifikativ të kësaj monografie “MEHDI ISLAM LUCA-SHEMBULLI I NJERIUT DHE NJERIU SHEMBULL”.

Vetë forma kompozicionale e librit me pesë kapituj: “ZALL DARDHA NË RRJEDHËN E HISTORISË”, “TARTAJ, NJË EMËR I ASHPËR”; “KARRIERA E SUKSESSHME E MEHDI LUCËS NGA DREJTUESI I LANÇ NË INSTITUCIONET DHE NDËRMARRJET E DIBRËS”; “KRIJIMTARIA LETRARE E MEHDI LUCËS” dhe “BASHKËKOHËSIT PËR MEHDI LUCËN”, është një qasje e veçantë e autorit H.Rama për ta bërë atë sa më tërheqës për lexuesin.

Është një libër objektiv, racional që përcjell vlera tek bashkëkohësit, qoftë me përshkrimin e ngjarjeve e fakteve të reja nga qëndresa e burrave të Dardhës kundër pushtuesve të huaj, ashtu dhe me portretizimet e babës Islam e të nënë Hanishes,

Luca, përveçse nga autori i mirënjohur Halil Rama, karakteri i tij burrëror, mençuria, mirësia njerëzore, thjeshtësia dhe vizioni i tij bashkëkohor, përcillen mjaftë qartë e bukur edhe nga opinionet e bashkëkohësve të tij si: Prof. Dr. Hajri Shehu, Hysen Laçi, Femi Luca, Shuaip Methasani, Skënder Cala, nga nipi i tij Dr. Zyber Gjoni, Idriz Kukeli, Muharrem Gjoka, Dogjan Dervishi, Bashkim Gjilaga, Avni Ndreu, Shpresa Gjoka, Xhemali Luca, nga e bija Kujtimja, mbesat Prof.asocdr. Keida ushtelenca, Azhena e Amanda Luca dhe Ligea Gjoni.

Nëpërmjet kësaj monografie lexuesi njihet me aktivitetin luftarak të Mehdi Lucës gjatë Luftës së lavdishme Antifashiste Nacionalçlirimtare, me kuadrin e devotshëm të shkolluar në të famshmin Internat i Kastriotit, me njeriun që sa qe gjallë vështrimin e kishte nga vendlindja.

Për të mos shuar kureshtjen e lexuesit, nuk po ndalem në hollësi- ra të librit, por dua të shtoj se kjo monografi ja vlen të lexohet dhe të pasurojë bibliotekën e çdo dibrani, pasi parasëgjithash është përjetësimi i të virtytshmit të paharruar Mehdi Luca.

Kjo monografi është një vepër e rëndësishme në ndihmë të banorëve

të Dardhës, e të atyre që janë larguar prej saj dhe që frymojnë në Tiranë e në hapësirën mbarëshqiptare në botë, e cila padyshim plotëson një boshllëk në historiografinë e një treve lavdiplotë si Zall Dardha, me të cilën krenohet edhe vetë autori Halil Rama, si nip i një familje të saj me emër.

E falenderoj autorin H.Rama edhe për faktin se ka shkruar thjeshtë dhe bukur një monografi kushtuar Mehdi Lucës, me të cilin jemi nga i njejtë fis (Në Tartaj, janë të një fisi: Luca, Pira, Gjoka, Bara, Xhaferi e Braka).

Libri monografik, “MEHDI ISLAM LUCA-SHEMBULLI I NJERIUT DHE NJERIU SHEMBULL”, i shkruar me një përkushtim dhe dashuri prej humlimesi, dokumentuesi, analisti nga pena e mirënjohur dhe kreative e Halil Ramës, është një vepër e një rëndësie, gjithësi të veçantë, së pari për komunitetin që i përket personazhi i saj, së dyti për brezat e ardhshëm, së treti për historinë dhe krijimin e një tradite të shkrimit të dokumentuar, traditë kjo, e cila i ka munguar dhe vazhdon t’i mungojë kulturës shqiptare.

## SUPLEMENTI LETRAT

# Zabit Lleshi, libër për dëshmorët e Bashkisë Bulqizë

Prof.asoc.dr. BERNARD ZOTAJ

Mjeshtër i Madh

Libri i autorit Zabit Lleshi "Yjet e lirisë së Bulqizës" ju kushtohet çetave partizane dhe territorial të zonës, dëshmorëve të atdheut që mbulon bashkia Bulqizë, baza të luftës, simbole për nderimin dhe vlerësimin e dëshmorëve dhe të partizanëve. Libri është një përpjekje serioze, por dhe e kohës, për të dëshmuar, por dhe për t'u ardhur në ndihmë institucioneve, shkollave, familjeve të dëshmorëve, veteranëve e familjeve të veteranëve, por dhe bibliotekave të njësive administrative dhe të bashkisë Bulqizë. Në vargun e luftërave që ka zhvilluar populli ynë në historinë e tij shumë shekullore për liri, pavarësi kombëtare e sovranitetit shtetëror, Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare (1939-1944) është epopeja më e lavdishme. Populli shqiptar këtë luftë e filloi para se të fillonte Lufta e Dytë Botërore, që në kohën e Luftës së Spanjës, shumë më përpara se të formohej Koalicioni Antifashist i Fuqive të Mëdha. Lufta e popullit shqiptar u bë pjesë e pandarë e luftës së madhe Antifashiste në të gjithë botën.

Librin Zabit Lleshi, me origjinë prej një familje fisnike, me kontribute dhe atdhetare të Dibrës, na e ka prurë me shumë dashuri dhe përkushtim për atë luftë titanike që breza të tërë do të jenë krenar, për ato sakrifica dhe atë mobilizim të një populli të tërë për ta parë veten të lirë dhe Atdheun të çliruar nga pushtuesit nazifashistë.

Autori me shumë mjeshtëri është përpjekur për të vlerësuar këtë kontribut popullor, por dhe për të nxjerr në dritë pas 80 viteve momentet kryesore të jetës së dëshmorëve të LANÇ, por dhe të dëshmorëve të ndërtimit të vendit. Dukuri e re është se autori pas çdo njohje me dëshmorin, ka dhënë dhe vendimet për shpalljen dëshmor nga Komitetet Ekzekutive të para viteve nëntëdhjetë si organe vendimmarrese, por dhe nga Komisioni i Statusit të Dëshmorit të Atdheut, që është pranë Ministrisë së Mbrojtjes. Për dëshmorët është shkruar në vite dhe vend të dukshëm ka zënë seria e "Yje të pashuar" të publikuar nga Resul Bedo, por dhe nga organet të shtypit të përditshëm, të cilat sot gjenden në biblioteka të qyteteve Peshkopi e Bulqizë, por dhe në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë, etj.

## NDERIMI PËR DËSHMORËT, TRADITË SHEKULLORE PËR SHQIPTARËT

Status ligjor për dëshmorët e Atdheut, para pavarësisë nuk ka pasë, por ata nderoheshin dhe respektoheshin nga populli për trimëritë e tyre të terguara në luftë. Statusi i tyre qëndronte i vendosur në këngë. Kënga ishte ligji dhe varri i tyre, nëpërmjet këngës dëshmorit bëhej i pavdekshëm. Por ligji i parë që përdorni emrin dëshmorë i përket vitit 1923, por pa specifikime të qarta. Ky ligj më tepër theksonte pensionet për familjet e dëshmorëve, për pensionet e ushtarakëve etj.

Pas çlirimit të vendit Kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar miratoi ligjin nr. 109 "Mbi shpërbimin e familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës, si dhe të atdhetarëve dhe familjeve të tyre, që i kanë sjellë shërbime të çmueshme Atdheut" më datë 28.08.1945. Në vitin 1969 ligji mori një statuturë të re dhe statusi i dëshmorit u punua dhe u specifikua termi "Dëshmor i Atdheut" duke i dhënë dhe mbështetje ligjore. Më vonë pasua në ligj në vitet 1988, 1994 dhe 2002. I fundit është ligji 109/2018 "Për Statusin e Dëshmorit të Atdheut". Ky ligj ka hapur hapsira të reja për një vlerësim dhe qëndrim ndaj të gjitha rasteve për t'u njohur e drejta çdo individit që ka dhënë gjak dhe ka humbur jetën në mbrojtje të vlerave kombëtare të kombit shqiptar. Ligji thekson se Dëshmorët, Familjet e Dëshmorëve përfaqësohen nga Organizata Kombëtare e Dëshmorëve të LANÇ dhe Dëshmorëve të tjerë të Atdheut, e cila ka qendrën në Tiranë, por dhe degët e saj në të gjitha bashkitë e vendin.

Autori me shumë përgjegjësi ka saktësuar për Bashkinë Bulqizë, sipas vendimeve të marra nga pushteti lokal dhe qendror, sipas përcaktimit të ligjit, ka sot të shpallur dëshmorë: 143 dëshmorë luftëtarë dhe patriotë të rënë para vitit 1939, në mbrojtje të lirisë dhe pavarësisë së vendit; 92 dëshmorë të rënë në vitet 1939-1944, si dhe 31 dëshmorë të tjerë të rënë në punën për ndërtimin e Atdheut dhe në ruajtjen e kufijve të Republikës së Shqipërisë.

## PËRMBAJTJA E LIBRIT TË FRYMËZN

Në libër një vend të rëndësishëm zënë çetat parti-

• *Autori me shumë mjeshtëri është përpjekur për të vlerësuar këtë kontribut popullor, por dhe për të nxjerr në dritë pas 80 viteve momentet kryesore të jetës së dëshmorëve të LANÇ, por dhe të dëshmorëve të ndërtimit të vendit*



## ATA JANË G.JITHMONË MES NESH



zane të Dibrës, ku theksi është vendosur në partizanët e çetës së Grykës së Vogël (20 qershor 1942), të çetës partizane të Martaneshit, 27 shtator 1942; të çetës partizane të Grykës së Madhe (15 shkurt 1943), të çetës partizane të Gollobordës (25 maj 1943), të çetës partizane të Sllovës (26 korrik 1943), të listave të partizanëve të tyre. Një vëmendje ju është kushtuar dhe çetave territorial, si çeta territoriale e Fushës së Dibrës dhe fshatrave rreth saj, çeta territoriale e Zerqanit, e Sopotit, e Bulqizës, e fshatrave të Qendrës Peshkopi, etj.

Një dukuri e re janë dhe evidentimi i bazave të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Bashkisë Bulqizës si të Grykës së Vogël, Grykës së Madhe, Bulqizë, Okshtun, Trebisht, Ostren, të Martaneshit, etj. Vend të dukshëm zënë dhe këshillat Antifashiste Nacionalçlirimtare të trevës së Bulqizës. Në vëmendje ka qenë dhe Konferenca Nacionalçlirimtare e Qarkut të Peshkopisë.

Autori në mënyrë të përmbledhur ka shkruar dhe për batalionin partizan të Dibrës, duke na përshkruar disa nga luftimet e zhvilluara prej tij si lufta e Sofrafanit, 23 gusht 1943; lufta e Peshkopisë, 17-19 tetor 1943; lufta e parë e Dibrës së Madhe, 31 tetor-3 nëntor 1943; lufta e dytë e Dibrës së Madhe, 16-17 nëntor 1943 etj. Përshkrimi i rrugëtimit të batalionit partizan të Martaneshit, të Operacionit të Dimrit (dhjetor 1943-janar 1944), të batalionit të dytë partizan të Martaneshit, etj. Më tej autori paraqet dhe rrugën luftarake të Brigadës XVIII Sulmuese në Qarkun e Dibrës të krijuar më 18 gusht 1944.

Në një kënd të dukshëm në faqet e librit jepet dhe jeta e Heronjve të Popullit të Dibrës e Martaneshit: Ramiz Varvarica, Nazmi Rushiti, Gjok Doçi, Hibe Palikuqi, Liman Kaba, Haxhi Halit Lleshi dhe Baba Faja Martaneshi (Mustafa Dalip Xhani).

Libri ka një prurje të re dhe pasqyron dhe të plagosur në luftë për rajonin që përfshin Bashkia e Bulqizës. Gjithashtu vend nderi zënë dhe heronjtë e Batrës në Martanesh, etj.

## MEMORIA HISTORIKE E BULQIZËS

Lapidarë, pllaka përkujtimore dhe bustet kushtuar ngjarjeve historike në Bashkinë Bulqizë janë të pakta, pavarësisht e në këtë trevë që nga koha e Skënderbeut, këtu janë zhvilluar luftëra për liri e pavarësi, organizuar kuvende e besëlidhje të ndritshme, duke dëshmuar për qëndresën e popullsisë e cila ka qenë e vazhdueshme dhe e përhershme kundër ushtrive pushtuese osmane, serbe, bullgare, italiane e gjermane etj.

Lapidarë që gjenden në Bashkinë e Bulqizës janë tek Ura e Topojanit, kushtuar përpjekjes së forcave italiane me çetën partizane, në Zogje kushtuar çetës partizane të Dibrës 20.6.1942, në Gjoricë kushtuar formimit të batalionit të Dibrës 26.7.1943, në Sofraçan, kushtuar betejës së Sofraçanit, 23 gusht 1943 dhe dëshmorëv Mexhit Tola e Kamber Xhafa, në Çerenec për batalionin "Antonio Gramshi", në Zerqan për çlirimin e Zerqanit, 3 gusht 1944, në Valikardhë për dëshmorin patriot Ramiz Daci, në Bulqizë për

aksionin e çetës në Minierën e Bulqizës, 16 shtator 1942, në Krastë, për 11 heronjtë e Batrës, në Gjon për çetën partizane të Martaneshit, etj. Në territorin e bashkisë gjendet dhe buste të Skënderbeut në vendin e quajtur "Gurët e Skënderbeut", të Mersim Demës në Shupenzë, të Fejzë Bulqizës në Bulqizë, të Minatorit në Bulqizë, të Elez Koçit në Ostren. Janë dhe këto emërtime të minierave: Miniera e Kromit Bulqizë "Todi Manço" dhe miniera e kromit Batër "11 heronjtë e Batrës".

Një prurje e re në libër është evidentimi në njësitë administrative të bashkisë me emra dëshmorësh të 5 shkollave fillore, të 22 shkollave 9 vjeçare, të 2 shkollave të mesme, të 2 qendrave shëndetësore dhe të një çerdhe fëmijësh. Një model libri që flet dhe dëshmon shumë për dëshmorët.

Autori ka shfrytëzuar për shkrimin e librit një bibliografi të pasur, e cila e ka ndihmuar në gjetjen dhe pasqyrimin e jetës dhe të veprimtarisë të 123 dëshmorëve të luftës dhe të ndërtimit të vendit për Bashkinë e Bulqizës. Ky është dhe libri i parë që përmbledh me një dokumentacion të pasur të gjithë dëshmorët e një bashkie. Nga kjo nismë e Zabit Lleshit, duhet të marrin shembull dhe studiues e historian, por dhe dashamirës të vepërës së dëshmorëve për të shkruar libër për dëshmorët e çdo bashkie të vendit.


Autori shprehet se në këto 80 vite nuk ka qenë e mundur të shkruhet për të gjithë dëshmorët, prandaj në përgatitjen e librit ka hasur në vështirësi dhe i është dashur të sigurojë të dhëna nga veteran të LANÇ-it, por dhe nga familjet e dëshmorëve, si dhe nga studiues të shumtë të historisë së luftës. Libri lë hapësira për të bërë studime dhe për t'u thelluar në jetën dhe veprimtarinë atpatriotike të dëshmorëve, por dhe të një populli, për të nxjerrë në dukje shpirtin patriotik e lirishtetë të njerëzve të thjeshtë, veprimtarinë luftarake të bërë nga luftëtarët në çeta, batalione e brigada sulmuese. Autori na njehtë me bazat e luftës të zonës, me kontributin e mdha të tyre, me aktivizimin gjerësisht të gruas dhe të vajzës shqiptare, por dhe të rinjve në shërbim dhe në ndihmë të luftës. Nëpërmjet mjaft të dhënave autori na tregon se si një popull i tërë i ktheu shtëpitë e tij në spitale partizane, në depo për furnizimin me ushqime dhe veshmbathje të luftëtarëve të malit. Kudo u shquan veprimtarët e forcave territorial të zonës të cilët në mjaft raste u bënë viktime dhe u masakruan për shkak të terrorit nazifashist.

Autori bën dhe një thirrje që puna duhet të vijojë edhe për mbledhjen e krijimtarisë për LANÇ, si për poezi, këngë, piktura, skulptura etj., që nuk janë pak në zonën e Bulqizës.

Në disa nga portretet e dëshmorëve të zonës, mungojnë foto të tyre, pasi ata dolën në luftë dhe nuk na lanë imazhin e tyre të bukur në foto, por është detyrë e familjarëve për t'u bërë portrete, por dhe për të gjetur materiale të tyre si, letra, foto, dorëshkrime e krijime të ndryshme, të cilat më parë ishin në muzeume, por me ndryshimin e sistemit u grabitë, u prishën, por sot koha i kërkon si dokumente dhe relike, që brezat të njohin dhe të shikojnë rinin e përjetshme të tyre.

Autori e pruri si dhuratë librin për rrugëtimin e dëshmorëve të Bashkisë Bulqizë, në kuadrin e 80 vjetorit të çlirimit të Atdheut, i ndihmuar për të parë dritën e botimit nga njeriu fisnik Baftjar Rifat Rusi. Libri është një muze për dëshmorët e Bulqizës, që dëshmon për jetën dhe veprën e atyre që në themelet e Atdheut vunë eshtrat dhe gjakun e tyre, të cilën ja dhuruan vendit të tyre. Librat për dëshmorët duhet të jenë të vijueshme dhe bashkia e njerëzit fisnik duhet të jenë në radhët e para për të parë dritën e botimit, nëpërmjet sponsorizimeve, por dhe nëpërmjet veprimtarive ku të zënë vend nderi dhe "Yjet e lirisë" të çdo bashkie.

## SUPLEMENTI LETRAT



U lind në fshatin Peladhi të ish-komunës Zerqan, rrethi Bulqizë, në një familje të varfër me tradita patriotike, atdhetare. Në vendlindje mbaroi shkollën fillore, ndërsa 7-vjeçaren e mbaroi në Zerqan.

Arsimin e mesëm e kreu në shkollën pedagogjike në Peshkopi. Mbaroi studimet e larta në Institutin e Lartë Pedagogjik në Shkodër. U diplomua në degën gjuhë shqipe dhe letërsi. Ka punuar mësues dhe drejtues shkolle në disa shkolla të rrethit. Në vitet 1997-2006 punoi në drejtorinë arsimore Bulqizë, si inspektor i gjuhës dhe i letërsisë, përgjegjës i sektorit të kontroll-kualifikimit-përgjegjës i sektorit të personelit dhe në ZA Bulqizë, këshillues i lëndëve shoqërore. Në vite ka qenë bashkëpunëtor i gazetës "Mësuesi", ku ka botuar disa shkrime me vlerë në fushën e mësimdhënies. Po kështu, ka botuar dhe vazhdon të botojë disa shkrime me vlerë në gazetën: "Rruga e Arbërit" dhe në organe të tjera të shtypit.

Ka botuar librat:

"Gryka e Madhe, vatra e dijes", "Yje që ndriçojnë Bulqizën", "Zerqani, mrekullia njerëzore", "Fshati në këmbët e Temlës".

Në të ardhmen ka në plan të botojë libra të tjerë nga fusha e studimeve të tij.

*Peladhi, je fshat i bukur,  
rrëzë Temlës ti je ulur.  
Emri i ka vënë historia,  
Skënderbeu me luftërat e tija.*

*Je fshat me traditë,*

## Dashuria për vendlindjen në poezinë e Destan Ramës



**Bujar Karoshi**

Libri "Poezi të shpirtit tim" i autorit Destan Rama vjen me një shtrirje të gjerë kohore dhe territoriale të trevave të Grykës së Madhe, Bulqizës e më gjerë. Në këtë vëllim ka poezi me fakte, të dëshmuara nga dokumente historike, nga kërkimet arkeologjike apo nga gojëdhënat popullore, në të gjithë territorin e këtyre trevave, si: Qyteza e Krajkës, e Sofraçanit, e Kokërdhokut, e Fushë Gurrës, Qyteti i Valikardhës etj.

Me interes lexohen poezitë që i kushtohen periudhës së Skënderbeut, betejave të tij, si edhe heronjve të rënë në këtë luftë. Vend të rëndësishëm zënë poezitë kushtuar themelimit të Qeverisë së Malit (Nëntë malet e Dibrës), domosdoshmërisë së krijimit të saj, luftës heroike kundër Hajredin Pashës në Fushën e Gjoricës, (Drini i Zi), heronjve të saj, si edhe udhëheqësit të malit, Sheh Mustafë Zerqanit.

Qëndresa heroike e popullit të këtyre trevave, si edhe e gjithë Dibrës, kundër pushtuesit mizor serb, përbëjnë një epike të lavdishme, bashkë me heronjtë e saj.

Të gjithë jemi të lidhur shpirtërisht me shenjtorët dhe vendet e shenjta, ndaj poezitë e shkruara për ata, përbëjnë një kureshtje më vete.

Epojeja e lavdishme e luftës antifashiste Nacionalçlirimtare zbulohet nëpërmjet poezive dhe heronjve të saj, të rënë në këtë luftë.

Nëpërmjet poezive, në libër, do të njihemi me përpjekjet e pareshtura të popullit të këtyre trevave për arsimin shqip. Populli i ktheu shtëpitë e tij në shkolla. Ajo zanafillën e saj e ka tek oda, atje të verbrit i erdhën sytë.

Destan Rama duket se frymëzimin për të shkruar poezi e merr nga vendlindja, nga fshati i tij, pasi për shumë ngjarje, ose i ka përjetuar vetë, ose i ka të dëguara nga rrëfimtaret popullorë. Destani jeton në fshat dhe përmes poezive duket, se e do shumë atë. aty ai u lind, u rrit, u edukua dhe u shkollua.

Bukuritë e dheut ndodhen në vendlindje dhe aty ai duket se njeh çdo gurë dhe çdo rrugicë, ndjen flladin, ajrin e freskët, aromën e luleve shumëngjyrëshe; shijon e i gëzohet çdo bukurie natyrore. Ai kënaqet me bukuritë dhe madhësitë e maleve, të fushave pjellore, me blegërimin dhe këmborët e deleve që i ngjiten temlës si ushtarët në stërvitje taktike.

Zëri i ëmbël i bilbilit, vaji i qyqes, fluturimi i dallëndyshes etj., e mahnitin dhe e bëjnë të lumtur.

Të gjitha këto më sipër ndjehen në poezitë e këtij vëllimi, ashtu siç ndjehet edhe urtësia, punët e mira, dashuria dhe respekti për njerëzit e mirë dhe të njohur të krahinës.

Destani ka qenë gjithë jetës së tij një mësues, që e ka dashur punën, që ka punuar dhe u ka mësuar qindra nxënësve dijen, me përkushtim, dashuri dhe fisnikëri. Dhe kujtimet e mira të punës si mësues i ka shprehur në poezitë kushtuar shkollës së dashur, mësuesve, nxënësve dhe kolegëve.

Njeriu vlerësohet për punët që bën, nderohet për veprën që lë pas. Në poezitë e këtij vëllimi do të lexoni për jetën dhe veprën e disa intelektualëve, të cilët i dhanë jetë e gjallëri trevave të tyre, u bënë modeli i punës, i shembullit frymëzues për brezat e ardhshëm.

Destan Rama ka punuar për shumë vite më-

- *Përmes poezive të këtij vëllimi mëson shumë për ngjarjet historike, udhëheqësit e luftërave në shekuj, dëshmorët, personalitetet dhe njerëzit e shquar të krahinës, për besimin në Zot dhe dashurinë për vendin, për natyrën e bukur*

sues në shumë treva të Bulqizës. Kjo i ka dhënë mundësinë të njohë mirë ngjarjet historike, traditat, zakonet, ritet, toponiminë, personalitetet, shenjtorët, luftëtarët dhe heronjtë që dhanë jetën për liri dhe pavarësi. Mali i Duriçit është për autorin një magji më vete: mbi sipërfaqe prodhon kastranin - rrëshirën e pishës me të cilën Skënderbeu prodhonte armët e luftës dhe, brenda në thellësi, mban kromin - këtë flori të nëntokës, që e bëri Bulqizën të njohur anembanë botës. Po aq magjishëm dhe plot mistere është edhe Qafa e Buallit (bollave), që është si portë hyrëse për në Mat, ura e Vashës e deri në brigjet e detit.

Përmes poezive të këtij vëllimi mëson shumë për ngjarjet historike, udhëheqësit e luftërave në shekuj, dëshmorët, personalitetet dhe njerëzit e shquar të krahinës, për besimin në Zot dhe dashurinë për vendin, për natyrën e bukur. Më shumë se sa një vepër letrare poetike, duket se autori kërkon përmes këtij vëllimi të ushqejë te lexuesi dhe, sidomos të rinjtë, dashurinë për vendlindjen. Në këto kohëra kur të rinjtë e kanë mendjen për të eksploruar vendet e botës, për të punuar dhe për të jetuar në dhera të huaja, ky vëllim poetik të fton në vendin tënd. Të njeh me historinë, traditën, kulturën, të tregon bukuritë dhe pasuritë e mëdha. të fton të kthehesh; të punosh dhe kontribuosh për vendlindjen tënde. Ky vëllim përcjell mesazhet e rilindësve tanë, se të punosh në vendin tënd, të luftosh për vendlindjen tënde, nuk ka gjë më të mirë e më të bukur dhe çdokënd e bën të lumtur!

## PROFILI

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË E KA KONSIDERUAR AKT HEROIK HUMAN DHE VETMOHUES

# MAJOR ELTON MYRKU, U MBYT NË DET PËR TË SHPËTUAR DY JETË

- *Elton Myrku është oficeri i parë shqiptar që ka stërvitur trupat e NATO-s. Si i tillë, në vitin 2010 ai është pjesë përbërëse e kontigjentit tonë ushtarak dhe flamurbajtësi i Flamurit tonë kombëtar në ceremoninë e parakalimit në krye të flamujve të 27 vendeve, me rastin e pranimit të Shqipërisë në NATO*



**Elton Myrku me flamurin tone kombëtar në krye, në parakalimin ceremonial në 2010 u prin flamujve të 27 vendeve anëtare me rastin e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO**

(Vijon nga fq.8)

muaj ka shërbyer në Kosovë, në ndihmë të Forcave Mbrojtëse të Kosovës.

Në vitin 2003, Elton Myrteza Myrku u titullua oficer aktiv, duke nisur kështu rrugën e vështirë dhe të bukur të jetës ushtarake në Forcat e Armatosura Shqiptare, e cila ju shkëput në mes, ditën e kryerjes së aktit heroik për shpëtimin e dy jetëve që po mbyteshin në det tek Plazhi i Gjeneralit. Pesë vjet më parë ai u pëcoll me të gjitha nderimet që meritonte për në banesën e fundit, me fjalë lamtumire nga një ush-

tarak i lartë në emër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm. Po ashtu, vlerësim shumë i lartë nga Prefekti i Qarkut Dibër, ish-ushtaraku shembullor Nexhbedin Shehu dhe nga hungarezi Petër, shef madhor i ushtrinë hungareze. Lamtumira ju dha nga familjarë, të afërm, miq e shokë, kolegë të tij, shok të njohur në shërbimin në Kosovë. Dhjetra bashkëstudentë të tij në Turqi janë shprehur me lotë në sy e dhimbje të thelle se krenoheshin me Eltonin, duke thënë në unison: “Ai ishte krenaria jonë dhe mburreshim me të...”.

Sot familja e tij, bashkëshortja Ro-

dina, djemtë Roeli dhe Joriku jetojnë në Frajburg të Gjermanisë: Rodina, fizikante atje, i madhi Roeli nxënës në klasën e tetë me rezultate të shkëlqyera dhe prej tre vitesh si shahist ka përfaqësuar Landin në takime kombëtare në rang Gjermanie (i vlerësuar me medalje e me titullin “mjeshtër në lojën e shahut” dhe lojtari më i mirë në të rinjtë.

Derisa i jati Eltoni, humbi jetën në një akt heroik, Roeli ishte shembullor me moshat e reja të “Partizani”-t në futboll, të cilat i përfaqësoi edhe në një takim në Gjermani. Gjithsesi, prindërit Myrtezai e

Serja, bashkëshortja Rodina, djemtë Roeli e Joriku jetojnë me dhimbjen por dhe me krenarinë për djalin, bashkëshortin dhe prindin shembullor, Elton Myrkun.

Ndaj dhe, për këtë karrierë të shkëlqyer ushtarake dhe për aktin heroik të pesë viteve më parë ai e meriton të shpallet “Dëshmor i Atdheut”.

## AKTUALITET

Në kuadrin e Konferencës Kombëtare të Organizatës së Dëshmorëve të Atdheut

# DEGA E ODA PUKË ZHVILLOI KONFERENCËN E TRETË



Këto ditë (18 qershor 2025) Dega e Organizatës së Dëshmorëve të Atdheut të Nën-prefekturës së Pukës, në kuadrin e Konferencës Kombëtare të Organizatës së D.A. (Shtator 2025), zhvilloi punimet e saja duke analizuar rezultatet e arritura dhe detyrat që dalin për të ardhmen. Raportin mbi veprimtyarinë e Degës e mbajti Kryetari i saj Z.Rasim Cina (familje D.A). Ai theksoi rolin e revistës “Dëshmorët e Atdheut” dhe të gazetës “Veterani”, për të vlerësuar sa duhet LANÇ të popullit shqiptar, si dhe kontributin e dhënë edhe nga populli i Pukës, i cili u rreshtua në çetat Pukë – Mirditë (me Komandant Pashk Curri dhe komisar Nuri Llazani i Qarkut Shkodër) si dhe çeta Pukë - Has (me Komandant Ymer Bardhos Laçi dhe komisar Isa Agaviku i Qarkut Shkodër), deri tek Batalioni Partizan “Triada” Puka (me Komandant Zef Miraka e Zef Gashi, komisar), që në kuadrin e Brigatës Partizane,

- *Studiuesi Xhemal Meçi – Mjeshtër i Madh paraqiti fakte që dëshmojnë se Puka ka luftuar pa epur kundër pushtuesve të huaj, sidomos kundër pushtuesve Osmanë, por edhe Serbo-Malazez dhe në kuadrin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878-’80)...*

XXII-S, mori pjesë në luftimet për çlirimin e qytetit të Shkodrës (29 Nëntor 1944).

Por del si detyrë e jona që t’i bëjmë sa më të njohura për edukimin e brezit të ri, si krenari e ndimesës së dhënë në kuadrin e LANÇ.

Njëkohësisht studiuesi Xhemal Meçi – Mjeshtër i Madh paraqiti fakte që dëshmojnë se Puka ka luftuar pa epur kundër pushtuesve te huaj, sidomos kundër pushtuesve Osmanë, por edhe Serbo-Malazez sidomos në kuadrin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878-’80).



400 malsorë pukas i shkuan në ndihmë Shkodrës së rrethuar nga pushtuesit Serbo-Malazezë 1912-’13, ashtu siç kanë shkuar 180 vullnetarë pukas në mbrotje të Plavë e Gucisë e të tjera aksione kombëtare për Liri e Pavarsi, që po i pasqyrojmë në librin “Dëshmorët e Pukës”, dy vëllimësh (Vëllimi I sapo ka dalë nga botimi).

Krahas kësaj pune, po punohet për një “Dhomë Muze” për Dëshmorët dhe Veteranët e Luftës së Degës Pukë.

Zonja Denisa Meçi, sekretare e Përgjithshme e Bashkisë Pukë përshëndeti në emër të Kryetarit të Bashkisë Pukë, Z.Rrok Doda, duke theksuar se Bashkia Pukë do ta ketë në konsideratë Degën e Organizatës D.A duke iu gjetur krahe dhe ndihmuar për mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve, lapidarëve dhe tabelave e emertimeve të udhëve e shesheve me emra dëshmorësh e veteranësh e Veteran të shquar në shkallë Nënprefekturë Puke e me gjerë.

Ndërsa Dr. Gjergji Velo premtoi që shqetësimet e familjeve të D.A t’ia paraqesë kryesisht Tiranë dhe Bashkive Pukë e Fushë-Arës.

Në përfundim ndau disa libra kushtuar D.A të Shqipërisë dhe disa Çertifikata Falenderimi e Vlerësimi për të gjithë ata që aktivizohen për pasqyrimin e lartësimin e figurës së D.A në veçanti studiuesit Xhemal Meçi “Mjeshtër i Madh” sapo nxori nga botimi Vëll.I D.A të Pukës dhe është në përgatitje për botimin e Vëll.II, duke dhënë një shembull për t’u lavdëruar për veprën madhore të D.A Brenda e jashtë Rethit Pukë. Së fundi u bënë zgjedhjet e reja.

**Përgatiti: Fadil Hyseni**  
**Gazetar pranë Bashkisë Pukë**